



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 130

Tiranë – E mërkurë, 6 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1, datë 27.1.2023	Për miratimin e formës dhe afateve të paraqitjes së të dhënave dhe informacionit për konsumin e energjisë..... 15475
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 19, datë 31.8.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, të ndryshuar..... 15479
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 203, datë 18.10.2022	Për miratimin e formatit të planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë dhe të raportit vjetor të progresit..... 15479
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 206, datë 25.10.2022	Për miratimin e formatit të planeve vendore të veprimit për efiçencën e energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planeve.. 15485
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 36, datë 2.8.2023	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” 15496
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 244, datë 9.8.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV..... 15531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 245, datë 9.8.2023	Mbi fillimin e procedurës, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”..... 15532
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 246, datë 9.8.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 15534

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 247, datë 9.8.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	15535
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 248, datë 9.8.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 31.3.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë HEC ‘Tërfoja’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Tërfoja’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”, i ndryshuar.....	15536
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 250, datë 16.8.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Sun Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw.....	15537
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 251, datë 16.8.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për licencim, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw.....	15538

**UDHËZIM****Nr. 1, datë 27.1.2023****PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE
AFATEVE TË PARAQITJES SË TË
DHËNAVE DHE INFORMACIONIT PËR
KONSUMIN E ENERGJISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 28, të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për eficientësin e energjisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Agjencia për Eficientësin e Energjisë (AEE) siguron informacionin dhe të dhënat, lidhur me konsumin e energjisë në vend dhe kostot e tyre përkatëse, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe dispozitat e këtij udhëzimi.

2. AEE-ja siguron informacion të përditësuar mbi të dhënat identifikuese të menaxherit të energjisë, të punësuar pranë Konsumatorit të Madh të Energjisë, sipas shtojcës III.

3. Çdo term i përdorur në këtë udhëzim, ka të njëjtin kuptim me termat në ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për eficientësin e energjisë”, të ndryshuar.

4. AEE-ja merr informacion dhe të dhëna lidhur me konsumin final të energjisë dhe konsumin e të gjitha llojeve të energjive nga:

a) personat fizikë ose juridikë privatë që zhvillojnë një aktivitet ekonomik ose social dhe konsumojnë energji;

b) personat fizikë ose juridikë, privatë të kategorizuar si konsumatorë të mëdhenj të energjisë;

c) institucionet shtetërore qendrore dhe vendore që konsumojnë energji;

ç) shoqëritë e shpërndarjes dhe/ose furnizimit me energji elektrike, gaz natyror, energji termike, nënprodukte naftë, qymyr, dru zjarri, biomasë ose çdo burim tjetër energjie, qofshin ato publike ose private;

d) AEE-ja mund të marrë informacion dhe të dhëna lidhur me konsumin e energjisë edhe nga INSTAT-i, Enti Rregullator i Energjisë apo çdo institucion tjetër qendror apo vendor që mbledh dhe grumbullon të dhëna apo informacione lidhur me konsumin e energjisë.

5. Të dhënat dhe informacioni që AEE-ja merr nga subjektet e përcaktuara në pikën 3, përfshijnë:

a) të dhëna të përgjithshme lidhur me përdoruesin e energjisë, përfshirë listën e objekteve që konsumojnë energji;

b) të dhëna lidhur me konsumin final të energjisë, tipat e energjive dhe kostot tyre;

c) të dhëna lidhur me tregues të caktuar që japin nivelin e eficientësisë së energjisë në aktivitetin e tyre.

6. Të dhënat dhe informacioni për konsumin e energjisë nga konsumatorët klasifikohet si i detyrueshëm ose opsional. Të dhënat dhe informacioni i detyrueshëm është ai që kërkohet për konsumatorët e mëdhenj të energjisë ose kur kërkohet specifikisht nga AEE-ja për konsumatorët e tjerë sipas këtij udhëzimi. Dërgimi i të dhënave opsionale është në vullnetin e lirë të përdoruesit të energjisë.

7. Me qëllim të identifikimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, AEE-ja zbaton procedurat e mëposhtme:

a) AEE-ja i kërkon Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)-së dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) që t'i dërgojnë brenda datës 31 janar të çdo viti listën e klientëve fundorë të energjisë elektrike që gjatë vitit paraardhës kanë pasur një konsum më të madh se 0.5 milion kWh;

b) të gjithë konsumatorët që rezultojnë me një konsum më të madh se 1 milion kWh energji elektrike gjatë vitit paraardhës përfshihen në listën e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, që krijohet dhe përditësohet nga AEE-ja sipas pikës 8 të këtij udhëzimi;

c) AEE-ja kërkon brenda muajit shkurt të çdo viti nga konsumatorët që kanë konsumuar 0.5-1 milion kWh gjatë vitit paraardhës të paraqesin të dhëna lidhur me konsumin e burimeve të tjera të energjisë, nëse kanë, për vitin paraardhës. Konsumatorët i dërgojnë të dhënat e kërkuara sipas kësaj shkronje brenda datës 31 mars;

d) AEE-ja bën llogaritjet e konsumit total të energjisë nga konsumatorët subjekt i shkronjës “c” të mësipërme i ekuivalentuar në kWh/vit sipas tabelës së konvertimit të shtojcës IV të këtij udhëzimi për eficientësin e energjisë dhe përfshin në listën e konsumatorëve të mëdhenj të gjithë konsumatorët me një konsum total të burimeve të energjisë më të madh se 1 milion kWh në vit.

8. AEE-ja krijon dhe mban një listë të përditësuar të të gjithë konsumatorëve të mëdhenj të energjisë të identifikuar sipas pikës 6, të cilët në përputhje me



dispozitat e ligjit nr. 124/2015 “Për efencencën e energjisë”, i ndryshuar, të cilët janë subjekt i dërgimit të detyrueshëm tek AEE-ja i të dhënave të konsumit të energjisë dhe kostove të tyre, për të gjitha llojet e burimeve të energjisë për vitin pasardhës në formatin e përcaktuar në shtojcat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

9. AEE-ja mund të kërkojë nga konsumatorët e tjerë të energjisë, të cilët nuk përfshihen në listën e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë dërgimin e të dhënave mbi konsumin dhe kostot respektive të burimeve të energjisë. Kërkesa me shkrim e AEE-së, do të përmbajë:

- a) llojin e së dhënës;
- b) njësitë matëse për të dhënat që kërkohen;
- c) periudhën për të cilën kërkohen të dhënat;
- d) formatin apo mënyrën se si do të dërgohen të dhënat;
- e) afatin brenda së cilës duhen dërguar të dhënat, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj nga dita e dërgimit të kërkesës.

10. Me qëllim të monitorimit të performancës energjetike të çdo objekti që konsumon energji, përveç të dhënave lidhur me konsumin e energjisë, AEE-ja kërkon nga konsumatorët përkatës të energjisë, qofshin ata të mëdhenj ose jo, edhe të dhëna lidhur me aktivitetin e tyre gjatë së njëjtës periudhë kohore në formën e treguesve të mëposhtëm:

- a) për bizneset tregtare dhe ndërtesat administrative konsumin e energjisë kundrejt sipërfaqes që përdoret për aktivitetin e tyre;
- b) për hotelet, spitalet dhe ndërtesat e tjera të përdorura për akomodim të personave (azilet, çerdhet, kopshtet etj.) konsumin e energjisë kundrejt sipërfaqes që përdoret, numrin e netëve të qëndrimit për person (pacient) për vit;
- c) për shoqëritë e transportit të njerëzve konsumin e energjisë (lëndës djegëse) kundrejt numrit të kilometrave të udhëtimit për pasagjer në një vit;
- d) për shoqëritë e transportit të mallrave konsumin e energjisë (lëndës djegëse) kundrejt numrit të kilometrave të transportuara për ton në një vit;
- e) për shoqëritë që përdorin energji për prodhimet e tyre konsumin e energjisë për produkt ose për ton prodhimi, si dhe konsumin e energjisë për çdo të punësuar.

11. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që janë të detyruar të dërgojnë të dhënat lidhur me konsumin dhe kostot e energjisë dhe konsumatorët e tjerë të cilëve nga ana e AEE-së iu kërkohet me shkrim të dërgojnë të dhëna mbi konsumin e energjisë sipas këtij udhëzimi do të sigurojnë që të dhënat e dërguara AEE-së janë të sakta dhe të vërteta. Në rast se AEE-ja konstaton apo verifikon se të dhënat dhe informacioni i dërguar nga konsumatorët e energjisë nuk janë të sakta ose të vërteta, ajo mund të marrë masa administrative në përputhje me dispozitat e nenit 26 të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për efencencën e energjisë”, i ndryshuar.

12. Për sektorët rezidencialë, bujqësisë dhe transportit, AEE-ja, në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me mbështetjen e autoriteteve vendore, ndërmerr kryerjen e sondazheve për mbledhjen e të dhënave për konsumin e energjisë nga konsumatorët në këta sektorë.

13. AEE-ja mund t'i kërkojë shoqërive të shpërndarjes së energjisë, operatorëve të sistemeve të shpërndarjes dhe/ose shoqërive të shitjes me pakicë të energjisë informacione të përmbledhura statistikore mbi konsumatorët finalë. Informacionet i dërgohen AEE-së, pas paraqitjes së kërkesës së kësaj të fundit, por jo më shpesh se një herë në vit. Ai mund të përfshijë informacion historik dhe aktual lidhur me konsumin e përdoruesve finalë, përfshirë kur është e mundur, profile të ngarkesës, segmentimin e klientëve dhe vendndodhjen gjeografike të tyre, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit që është i karakterit privat ose i ndjeshëm nga pikëpamja tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Të dhënat për konsumin e energjisë nga institucionet dhe entitetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe forcave të armatosura, mbledhen nga AEE-ja në koordinim me ministrin e Mbrojtjes dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit specifik në fuqi.

15. Për përmbushjen e detyrave të saj, AEE-ja mbledh të dhëna lidhur me konsumin e energjisë nga persona ose individë nga organe të tjera publike nëse ato kanë autoritetin ligjor për mbledhjen e këtyre të dhënave.

16. Me qëllim të përmirësimit të procesit të mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, përdorimit dhe publikimit të të dhënave për konsumin e energjisë, AEE-ja krijon dhe mban një Bazë të Dhënash



Elektronike lidhur me konsumin e energjisë. AEE-ja merr të gjitha masat e arsyeshme për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe informacionit të dërguar nga konsumatorët e energjisë dhe entitetet e tjera publike sipas këtij udhëzimi.

17. Të dhënat dhe informacioni i marrë dhe i mbledhur nga AEE-ja sipas këtij udhëzimi janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të AEE-së për eficientë e energjisë. AEE-ja ndërmerr të gjitha masat teknike dhe organizative sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar duke siguruar mbrojtjen e këtyre të dhënave gjatë përpunimit,

përdorimit apo publikimit të tyre.

18. AEE-ja publikon të dhëna lidhur me konsumin e energjisë në faqen zyrtare të internetit të saj duke ruajtur privatësinë dhe konfidencialitetin e informacionit të tyre.

19. Ngarkohet Agjencia për Eficientë e Energjisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA I KONSUMI I BURIMEVE ENERGJETIKE

	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Vlerakal.</i>	<i>Jan.</i>	<i>Shku.</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qer.</i>	<i>Korr.</i>	<i>Gush.</i>	<i>Shta.</i>	<i>Tet.</i>	<i>Nën.</i>	<i>Dhje.</i>
En. elektrike	kWh	kWh												
Diezel	litra	kJ/kg												
Benzinë	litra	kJ/kg												
Solar	ton	kJ/kg												
Vajguri	litra	kJ/kg												
Gaz i lëngëzuar i naftës (LPG)	ton	kJ/kg												
Gaz natyror (përfshirë gazin natyror të lëngëzuar (LNG) dhe gazin natyror të kompresuar (CNG))	1000m ³ N	kJ/m ³ N												
Linjiti	ton	kJ/kg												
Koks	ton	kJ/kg												
Antraciti	ton	kJ/kg												
Dru zjarri	m ³ stere	kJ/m ³ stere												
Peleta ose briketa druri	ton	kJ/kg												
Avull	ton	Kkal												
Ujë i ngrohtë	ton	Kkal												

SHTOJCA II ÇMIMET E BLERJES SË BURIMEVE ENERGJETIKE (në lekë)

	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Jan.</i>	<i>Shku.</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qer.</i>	<i>Korr.</i>	<i>Gush.</i>	<i>Shta.</i>	<i>Tet.</i>	<i>Nën.</i>	<i>Dhje.</i>
En. elektrike	lek/kwh												
Diezel	lek/litra												
Benzinë	lek/litra												
Solar	lek/ton												
Vajguri	lek/litra												
Gaz i lëngëzuar i naftës (LPG)	lek/kg												
Gaz natyror	lek/1000m ³												



(përfshirë gazin natyror të lëngëzuar (LNG) dhe gazin natyror të kompresuar (CNG))	N												
Linjit	lek/ton												
Koks	lek/ton												
Antracit	lek/ton												
Dru zjarri	lek/m ³ stere												
Peleta ose briketa druri	lek/ton												
Avull	lek/ton												
Ujë i ngrohtë	lek/ton												

SHTOJCA III

Të dhëna	
Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Datëlindja	
Arsimi i lartë	
Nr. i certifikatës	
Kohëzgjatja e kontratës së punësimit	

SHTOJCA IV

PËRMBAJTJA ENERGJIKE E LËNDËVE TË ZGJEDHURA
PËR PËRDORIM FINAL – TABELA E KONVERTIMIT

Bartësi energjisë	<i>kJ (VKN)</i>	<i>Kgoe (VKN)</i>	<i>kWh (VKN)</i>
1 kg qymyr	28 500	0,676	7,917
1 kg qymyr i fortë	17 200 — 30 700	0,411 — 0,733	4,778 — 8,528
1 kg briketa qymyr ngjyrë kafe	20 000	0,478	5,556
1 kg linjit i zi	10 500 — 21 000	0,251 — 0,502	2,917 — 5,833
1 kg qymyr kaf	5 600 — 10 500	0,134 — 0,251	1,556 — 2,917
1 kg naftë guri argjilor	8 000 — 9 000	0,191 — 0,215	2,222 — 2,500
1 kg torfe	7 800 — 13 800	0,186 — 0,330	2,167 — 3,833
1 kg briketa torfe	16 000 — 16 800	0,382 — 0,401	4,444 — 4,667
1 kg mazut	40 000	0,955	11,111
1 kg mazut i lehtë	42 300	1,010	11,750
1 kg benzinë	44 000	1,051	12,222
1 kg diezel	42 300	1,010	11,750
1 kg vajgur	40 000	0,955	11,111
1 kg gaz (GLN)	46 000	1,099	12,778
1 kg gaz natyror (93% metan)	47 200	1,126	13,10
1 kg gaz natyror i lëngshëm	45 190	1,079	12,553
1 kg dru (25% lagështi)	13 800	0,330	3,833
1 kg pelet	16 800	0,401	4,667
1 kg mbetje	7 400 — 10 700	0,177 — 0,256	2,056 — 2,972
1 MJ nxehtësia e përftuar	1 000	0,024	0,278
1 kWh energji elektrike	3 600	0,086	1



UDHËZIM

Nr. 19, datë 31.8.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 10, DATË 30.3.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
PËRBËRËSE, FORMËN E DIPLOMËS
OSE CERTIFIKATËS SË LËSHUAR NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË DHE PROCEDURËS SË
REGJISTRIMIT TË TYRE NË
REGJISTRIN SHTETËROR TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR ARSIMIN E LARTË DHE
KËRKIMIN SHKENCOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 91 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) Shkronja “gj” e pikës 1, të kreut II, të riformulohet si më poshtë:

“gj) Emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shkrim dorë. Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një LAL-je vendoset emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shkrim dorë.”.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR

Nr. 203, datë 18.10.2022

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË
PLANEVE TË VEPRIMIT TË
KONSUMATORËVE TË MËDHENJ TË
ENERGJISË DHE TË RAPORTIT
VJETOR TË PROGRESIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 11, pika 6, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të planeve të veprimit për konsumatorët e mëdhenj të energjisë dhe të raportit të progresit, sipas shtojcave 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij.

2. Planet e veprimit të konsumatorëve të mëdhenj (në vazhdim PVKM-ja) hartohen në bazë të raportit të auditimit të energjisë për konsumatorët e mëdhenj, të kryer nga një auditues i licencuar, dhe ndër të tjera duhet të:

a) përcaktohet viti i referimit, i cili duhet të përkohet me vitin e përzgjedhur për hartimin e raportit të auditimit të energjisë;

b) përcaktohet periudha e nevojshme për zbatimin e planit, e cila nuk duhet të jetë më pak se 3 vjet nga momenti që subjekti auditohet dhe në çdo rast jo më shumë se 10 vjet;

c) përcaktohet objektivi i synuar për arritjen e kursimeve të energjisë, respektivisht vitit të referimit;

3. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë (në vazhdim AEE) garanton gjurmueshmërinë e të gjithë procesit duke:

a) pajisur me një numër unik të gjithë raportet e auditimit të konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, pasi verifikon që ato janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) pas procesit të mësipërm, AEE njofton menaxherin e energjisë të punësuar pranë KME-së dhe/ ose KME-së, për miratimin e raportit dhe i komunikon numrin unik të identifikimit;

c) menaxheri i energjisë duhet të hartojë planin e veprimit, brenda 60 ditësh nga data e njoftimit. Plani i veprimit mund të rishikohet me lejen e AEE-së, pas kërkesës së menaxherit të energjisë;

d) kërkesa për rishikim duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur, masat që shtohen ose



ndryshohen, si dhe objektivat e reja në kursimet e energjisë, kursimet e lëndëve të para, dhe reduktimin e gazeve me efekt serrë;

e) gjatë procesit të hartimit të planit, menaxheri i energjisë mund të konsultohet me AEE-në dhe MIE-n për të garantuar përputhje me objektivat kombëtare;

f) menaxheri i energjisë dërgon planin e përfunduar tek AEE, brenda afateve të përcaktuara sipas pikës “c”;

g) AEE e miraton ose e kthen me komente, brenda 5 ditëve pune, planin e veprimit. Reflektimi i komenteve realizohet brenda 15 ditëve pune dhe plani i përfunduar ridërgohet tek AEE, nga menaxheri i energjisë;

h) AEE miraton dhe pajis me një numër unik planin e veprimit. Numri unik do të shoqërojë çdo raport progresi të dërguar nga KME-ja, gjatë tre viteve që pasojnë.

4. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001, përdorin formatin e shtojcës 2, për të raportuar arritjet në reduktimin e energjisë.

5. Ngarkohet agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dhe konsumatorët e mëdhenj të energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA 1

[Vendos logon e konsumatorit të madh]
**Konsumatori i madh [Emri i KM-së]
Plani i veprimit të konsumatorit të madh**

1. Informacion i përgjithshëm mbi konsumatorin e madh të energjisë

1.1 Të dhëna të përgjithshme

Emërtimi i konsumatorit të madh	
Aktiviteti kryesor	
Numri i punonjësve	
Administratori i objektit	
-Adresa/ kodi postar	
-Nr. i telefonit	
-Email	

PVEE [20__ – 20__]

Përgatitur nga

[Emër, mbiemër, nr. i certifikatës]

Data dd.mm.yyyy

Plani i veprimit për efikasitetin e energjisë

[Emri i konsumatorit të madh]

për periudhën [viti fillestar – viti i fundit]

Përmbledhje

1. Informacion i përgjithshëm mbi konsumatorin e madh të energjisë

1.1 Të dhëna të përgjithshme

1.2 Përshkrim i aktivitetit që zhvillohet në objekt

1.3 Informacion i përgjithshëm mbi planin e veprimit

1.4 Objektivat për kursimet e energjisë

2. Informacion për menaxhimin e energjisë, pajisjet dhe sistemet teknike

3. Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4. Analiza dhe argumentimi i implementimit të masave

Lista e tabelave

Tabela 1-1 Të dhëna mbi konsumatorin e madh

Tabela 2-1 Të dhëna mbi pajisjet dhe sistemet teknike të instaluar (të përcaktohen për çdo pajisje që preket nga plani i veprimit)

Tabela 3-1 Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, afati kohor dhe kostot e vlerësuara

Tabela 3-2 Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, afati kohor dhe kostot e vlerësuara

Plani i veprimit për efikasitetin e energjisë _____ [emri i KM] përcakton strategjinë e zhvillimit të efikasitetit të energjisë për konsumatorin e madh të energjisë (KME) dhe masat që do të zbatohen gjatë periudhës trevjeçare [viti fillimit – viti përfundimit], në përputhje me dispozitat e nenit 11, pika 6, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, të ndryshuar.



Nr. i kontratave (FSHU) dhe adresat	
Viti i kategorizimit si KME	
Audituesi i energjisë	
-Nr. i certifikatës	
-Adresa/ kodi postar	
-Nr. i telefonit	
-Email	
Numri unik i raportit të auditimit të energjisë	
Data e hartimit të planit të veprimit	
Menaxheri i caktuar i energjisë	
-Nr. i certifikatës	
-Adresa/ kodi postar	
-Nr. i telefonit	
-Email	

Tabela 1-1: Të dhëna mbi konsumatorin e madh.

1.2 Përshkrim i aktiviteteve që zhvillohen në objekt

(Ky seksion duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar ndryshimet që parashikohet të ndodhin në zhvillimin e aktiviteteve pas ndjekjes së rekomandimeve të audituesit të energjisë. Përshkrimi në rastin e objekteve duhet të ndahet në zona, sipas

1.3 Informacion i përgjithshëm mbi planin e veprimit

Përmbledhje e aktiviteteve të subjektit:
 Energjia e konsumuar para auditimit:
 Energjia e konsumuar pas zbatimit të planit:
 Vlera totale e parashikuar e investimit:
 Produktet kryesore (nëse ka):
 Format kryesore të energjisë të përdorur:
 Mënyra e funksionimit (nr. i turneve/ditë, ditë/vite):.....

1.4 Objektivat për kursimet e energjisë

Në këtë paragraf duhet të përshkruhen shkurtimisht objektivat e KME-së gjatë periudhës së nevojshme për zbatimin e këtij plani. Në çdo rast objektivat duhet të vendosen duke pasur në konsideratë vitin referues të përzgjedhur gjatë realizimit të auditimit energjetik, i cili duhet të jetë i njëjtë me vitin referues të përcaktuar në planin për energjinë dhe klimën. Gjithashtu të paraqitet një analizë lidhur me shkaqet dhe rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e objektivave të synuara.

aktiviteteve të zhvilluara në secilën prej tyre. Përshkrimi duhet të përfshijë edhe ndryshime në oraret e aktivitetit, ndryshime sjelljeje, ndryshimet që mund të rezultojnë nga prokurimi i teknologjive të reja, etj.)

2. Informacion për menaxhimin e energjisë, pajisjet dhe sistemet teknike

Të përshkruhen të gjitha pajisjet apo sistemet teknike që do të përmirësohen duke pasur si synim rritjen e performancës së tyre energjetike. Kjo mund të përfshijë operacione mirëmbajtjeje, zëvendësim ose çdo mënyrë tjetër që është identifikuar gjatë realizimit të auditimit energjetik. Në çdo rast, të bëhet një krahasim ndërmjet situatës ekzistuese dhe situatës që synohet të arrihet dhe të specifikohet nëse masa e përzgjedhur për t'u zbatuar është nën rekomandimet e audituesit, sipas rekomandimeve apo i tejkalon ato.



Pajisja ose sistemet teknike						
Nr.	Emri i pajisjes dhe funksioni	Viti i prodhimit	Nr. i serisë	Konsumi (kwh/vit)	Oraret e punës	Treguesi i EE-së
1	Pajisje ekzistuese					
2	Pajisje e re/ apo e përmirësuar					

Tabela 2-1: Të dhëna mbi pajisjet dhe sistemet teknike të instaluar (të përcaktohen për çdo pajisje që preket nga plani i veprimit).

Konsumi (kwh/vit) sipas			
Vitit referues	Rekomandimet e auditit	Fakti	Plani

Tabela 2-2: Të dhëna krahasuese mbi konsumin para dhe pas implementimit të masave të efikasitetit.

3. Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Masat për të përmirësuar efikasitetin e energjisë mund të përfshijnë investime dhe masa për të ruajtur energjinë (masa pa kosto) dhe rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (siç është përdorimi i biomasës për ngrohje, sistemet termike diellore për prodhimin e ujit të nxehtë, sistemet fotovoltaike për gjenerimin e energjisë elektrike, etj.).

Masat për të përmirësuar efikasitetin e energjisë mund të synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në objektet e konsumatorëve të mëdhenj.

Për plotësimin e këtij seksioni rekomandohet të përdoret tabela nr. 5, e cila duhet të japë një pasqyrë të masave të përzgjedhura për përmirësimin e efikasitetit të energjisë të planifikuara për një periudhë trevjeçare, me një afat kohor, si edhe

kostot e vlerësuara për zbatimin e programit të përmirësimit të efikasitetit të energjisë dhe kursimet e pritshme vjetore.

Parametrat e identifikuar në tabelën e mëposhtme duhet të jenë vlerësuar nga menaxheri i energjisë, në përputhje me masën specifike që do të implementohet. Masa që do të zbatohet duhet t'i referohet pajisjeve specifike, vlerave konkrete dhe skedave teknike ose katalogëve në të cilat treguesit kryesorë të pajisjeve, teknologjive, sistemeve, etj. tregohen në vlerat e tyre nominale. Në këtë mënyrë është e nevojshme që kursimet e pritshme vjetore të energjisë dhe të lekëve, vlera e investimit dhe afati i vetëshlyerjes të rillojë për çdo rast specifik. Katalogët dhe skedat teknike për masat që do të implementohen duhet të jenë pjesë e planit të veprimit në formën e shtojcave.

Nr.	Emërtimi i masës	Përshkrimi i shkurtër i masës (masat specifike të EE-së që parashikohen të zbatohen)	Periudha e zbatimit (muaji fillestar/viti – muaji i fundit/viti)	Kursimet e pritshme vjetore të energjisë (kwh)	Kursimet e pritshme vjetore (lek)	Investimi kapital (lek)	Afati i vetëshlyerjes
1							
2							
3							
...							

Zgjerimi sipas nevojës

Tabela 3-1: Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, afati kohor dhe kostot e vlerësuara.

Për të gjitha masat që propozohen në raportin e auditimit të energjisë por që nuk janë përzgjedhur për t'u zbatuar sipas këtij plani, duhet të identi-

fikohen sipas tabelës së mëposhtme dhe të komentohet arsyet që kanë çuar në mospërzgjedhjen e tyre.



Nr.	Emërtimi i masës	Kursimet e pritshme vjetore të energjisë (kwh)	Kursimet e pritshme vjetore (lek)	Investimi kapital (lek)	Afati i vetëshlyerjes	Komente
1						
2						
3						
...						

Zgjerohen sipas nevojës

Tabela 3-2: Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, afati kohor dhe kostot e vlerësuara.

4. Analiza dhe argumentimi i implementimit të masave

Në këtë seksion të përshkruhen të përmblëdhura gjetjet kryesore dhe projektet e rekomanduara, kursimet e energjisë

.....

SHTOJCA 2

RAPORT MBI ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË [shkruani emrin e konsumatorit të madh]

Ky raport paraqet masat për efikasitetin e energjisë _____ vjet [vitin e kaluar]

Përmbajtja

1. Të dhëna për personat përgjegjës
2. Përmbushja e detyrimeve të raportimit
3. Hyrje
4. Raport mbi zbatimin e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4.1 Raportimi i aktiviteteve të zhvilluara të parapara me planin për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4.2 Rishikimi i përdorimit të burimeve financiare për zbatimin e planit për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4.3 Masa të tjera të zbatuara për efikasitetin e energjisë që nuk mbulohen nga plani për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4.4 Devijimet nga plani dhe masat korrigjuese

5. Vlerësimi i efekteve të masave të zbatuara

Lista e tabelave

Tabela 1-1 Të dhënat e personave përgjegjës

Tabela 1-2 Të dhënat e grupit të punës

Tabela 2-1 Të dhënat e raportit

Tabela 3-1 Përmbledhje e të dhënave kryesore

Tabela 4-1 Raportimi i zbatimit të masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë të parapara në planin e veprimit për vitin [vitin e kaluar]

Tabela 4-2 Përdorimi i burimeve financiare për zbatimin e planit të vitit: [vitin e kaluar]

1. Të dhëna për personat përgjegjës

Emri dhe kontaktet e personit përgjegjës për menaxhimin e energjisë nga KME-ja dhe përgatitja dhe miratimi i raportit në fjalë jepen në tabelat e mëposhtme:

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (menaxheri i energjisë)	
Adresa/kodi postar	
Telefon	
Nr. i kontaktit	

Tabela 1-1: Të dhënat e personave përgjegjës.

Grupi i punës për zhvillimin e raportit			
Emri			...
Mbiemri			...
Pozicioni			...
Nr. i kontaktit			...
Email			...

Tabela 1-2: Të dhënat e grupit të punës.



2. Përbushja e detyrimeve të raportimit

Raporti/të dhënat	Numri unik i planit të veprimit	Data e paraqitjes së raportit
Raport mbi zbatimin e planit të KME-së të efikasitetit të energjisë për vitin [viti të kaluar]		

Tabela 2-1: Të dhënat e raportit.

Në rast të mospërbushjes ose vonesës në përbushjen e disa detyrimeve nga tabela 1, është e nevojshme të deklarohen arsyet e mospërbushjes ose vonesës dhe të deklarohen veprimet korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara.

3. Hyrje

Në këtë seksion të jepet pasqyra e përgjithshme e të gjitha masave të ndërmarra në kuadër të

efikasitetit të energjisë dhe burimeve të rinovueshme të energjisë (p.sh. mund të vendosen të dhëna lidhur me numrin e ndërtesave të rinovuara apo llambave të zëvendësuara, implementimin e sistemit të menaxhimit të energjisë, etj.). Përveç kësaj është e nevojshme të identifikohen treguesit gjithëpërfshirës sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Njësia	Vlera
Objektivi për kursimin e energjisë	mwh	
Energji e kursyer (aplikimi i masave të efikasitetit të energjisë)	mwh	
Konsumi final i energjisë	mwh	
Konsumi primar i energjisë	mwh	
Kapaciteti i instaluar i burimeve të rinovueshme të energjisë	mwp	

Tabela 3-1: Përmbledhje e të dhënave kryesore.

4. Raport mbi zbatimin e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

4.1 Raportimi i aktiviteteve të zhvilluara të parapara me planin për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Nr.	Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë	Vlera e Investimit	Arsyet për moszbatimin e masës	Data e zbatimit të masës	Jetëgjatësia (vite)	Bartësi i energjisë (i afektuar respektivisht masës)	Kursimet e arritura vjetore të energjisë (kwh)
1							
2							
3							
...							

Tabela 4-1: Raportimi i zbatimit të masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë të parapara në planin e veprimit për vitin [viti të kaluar].

4.2 Rishikimi i përdorimit të burimeve financiare për zbatimin e planit për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Buxheti i përgjithshëm i ndarë për zbatimin e planit për vitin [viti paraprak] ishte ____ lekë.

Nr.	Masa e përmirësimit të EE-së	Buxheti i parashikuar plani (lek)	Shuma e kostove aktuale (lek)	Komente
1				
2				
3				
4				
NË TOTAL				

Tabela 4-2: Përdorimi i burimeve financiare për zbatimin e planit të vitit: [viti të kaluar].



4.3 Masa të tjera të zbatuara për efikasitetin e energjisë që nuk mbulohen nga plani për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Përkthimi shkurtimisht çdo masë shprehëse që është zbatuar, megjithatë nuk është parashikuar në planin për përmirësimin e efikasitetit të energjisë për vitin e kaluar. Gjithashtu, jepni informacion mbi burimet e financimit për masat e EE-së dhe buxhetet e përdorura për zbatimin e tyre.

4.4 Devijimet nga plani dhe masat korrigjuese

Listoni masat që paraqesin devijime nga plani i përmirësimit të efikasitetit të energjisë (nëse ka), si dhe:

- arsyet e devijimeve dhe vonesave;
- një përshkrim të masave korrigjuese të marra ose të planifikuara për të kompensuar vonesat dhe për të zbutur pasojat e devijimeve nga plani i përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

5. Vlerësimi i efekteve të masave të zbatuara

Paraqitni një vlerësim cilësor ose sasior të kursimeve të energjisë të arritura si rezultat i zbatimit të planit për vitin e kaluar, si dhe informacion nëse janë arritur qëllimet e përcaktuara. Gjithashtu, nëse është e mundur të paraqitet një analizë krahasuese e të dhënave të konsumit të energjisë, tendencave të konsumit të energjisë, të dhëna për vënien në punë të pajisjeve të reja, si dhe fakte të tjera që konfirmojnë vlerësimin e dhënë.

Gjatë analizimit të të dhënave, është e nevojshme të merret parasysh fakti se efektet e planit vjetor vërehen kryesisht në vitin pas zbatimit të planit, megjithatë mund të realizohen disa kursime gjatë

vitit në të cilin plani zbatohet (sidomos gjatë muajve të fundit).

URDHËR

Nr. 206, datë 25.10.2022

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË PLANEVE VENDORE TË VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË DHE RAPORTI I PROGRESIT PËR ZBATIMIN E PLANEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 9/1, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të Planeve Vendore të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë dhe Raportit të Progresit për Zbatimin e Planeve, sipas shtojcave 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Agjencia për Efikasitetin e Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**



SHTOJCA 1

[Vendos logon e Bashkisë]
Bashkia [Emri i njësisë së qeverisjes vendore]
Plani vendor i veprimit për efikasencën e energjisë PVVEE [20__ – 20__]
(Muaj, viti)
Hartuar me mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë për
Efikasencën e Energjisë



Plani vendor i veprimit për efikasencën e energjisë
[Emri i njësisë së qeverisjes vendore]
për periudhën [viti fillestar – viti i fundit]

Plani vendor i veprimit për efikasencën e energjisë _____ [emri i njësisë së qeverisjes vendore] përcakton strategjinë e zhvillimit të efikasencës së energjisë në nivel vendor dhe masat që

do të zbatohen me prioritet gjatë periudhës trevjeçare [viti fillimit – viti përfundimit] në përputhje me dispozitat e nenit 9/1, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasencën e energjisë”, i ndryshuar.

1.1 Të dhëna për personat përgjegjës

Emri dhe mbiemri dhe kontaktet e personave përgjegjës për menaxhimin e energjisë nga njësi e qeverisjes vendore, përgatitja e programit dhe miratimi i tij jepen në tabelat e mëposhtme:

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (menaxheri i energjisë)	
Adresa/ kodi postar/ Bashkia	
Telefon	
Celular	

Grupi i punës për zhvillimin e planit			
Emri			
Mbiemri			
Pozicioni			
Telefon			
Celular			
E-mail			

Tabela e përmbajtjes

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM

1.1 Kuadri ekzistues – baza e Planit Vendor të Efikasencës së Energjisë

1.2 Qëllimi dhe objektivat

1.3 Zbatimi dhe monitorimi

2. STATUSI AKTUAL NË KONSUMIN E ENERGISË DHE EFICASENCËN E ENERGISË

2.1 Objektet dhe aktivitetet/ shërbimet e njësisë së qeverisjes vendore

2.1.1 Vështrim i përgjithshëm i konsumit të energjisë

2.1.2 Ndërtesat publike

2.1.3 Sistemi i furnizimit me ujë

2.1.4 Sistemi i trajtimi/ largimit të ujërave të zeza

2.1.5 Ndriçimi publik dhe sinjalistika e trafikut

2.1.6 Transporti publik (nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore)

2.1.7 Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve

2.1.8 Makinat e pasagjerëve dhe minibusët (nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore)



2.1.9 Aktivitete/shërbime tjera të qeverisjes vendore

2.2 Konsumi i energjisë në sektorin rezidencial dhe sektorë të tjerë në territorin e qeverisjes vendore

3. MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

3.1 Pasqyra e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

3.2 Analiza e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

3.2.1 Analiza e masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesa publike/ private/ ndriçim publik/ transport publik/ sistemet e furnizimit me ujë/ etj.

4. SKEMAT E FINANCIMIT DHE PLANI FINANCIAR

4.1 Skemat e financimit

4.2 Plan i financiar

Lista e tabelave

Tabela 2.1.1 Konsumi total i energjisë dhe kostot sipas llojit të burimit të energjisë për vitin (për të gjitha aktivitetet/shërbimet e njësisë së qeverisjes vendore)

Tabela 2.1.2: Konsumi total i energjisë sipas sektorëve

Tabela 3.1.1: Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, afati kohor dhe përgjegjësitë dhe mënyra e zbatimit të programeve të përmirësimit të efikasitetit të energjisë [viti fillestar – viti i fundit]

Tabela 3.1.2 Kostot e parashikuara për zbatimin e programeve të përmirësimit të efikasitetit të energjisë

Tabela 3.2.1: Analiza financiare e masave të efikasitetit të energjisë

Tabela 4.2.1: Burimet e financimit dhe plani financiar i programit të përmirësimit të efikasitetit të energjisë

1. KUADRI I PËRGJITHSHËM

1.1 KUADRI EKZISTUES – BAZA E PLANIT VENDOR TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË

Ky kapitull përshkruan shkurtimisht kuadrin ekzistues dhe mënyrën në të cilën Plan i Vendor i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë lidhet me politikat kombëtare të efikasitetit të energjisë duke përfshirë Strategjinë Kombëtare të Energjisë (SKE), si dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK). Ai gjithashtu ofron informacion bazë që justifikon prioritetet e programeve të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Ndër të tjera, ky kapitull duhet të përmbledhë:

- shfrytëzimin bazë të energjisë në objekte, aktivitetet e qeverisjes vendore, problemet kryesore lidhur me efikasitetin e energjisë, si dhe mundësitë e disponueshme për arritjen e kursimeve të energjisë;

- mundësitë për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike e private, sistemet e furnizimit me ujë, sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura, ndriçimin publik, si dhe përmes masave horizontale;

- mundësitë për rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë;

- rishikimi i rregulloreve që do të zbatohen nga qeverisja vendore përmes zbatimit të programeve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;

- masat për përmirësimin e efikasitetit energjetik nga PKEK, të cilat mund të zbatohen nga njësitë e qeverisjes vendore;

- nisma të tjera të qeverisjes vendore në lidhje me efikasitetin e energjisë (p.sh. përfshirja në iniciativën e Kartës së Kryetarëve të Bashkive të Qyteteve Evropiane etj.);

- një përmbledhje e shkurtër e mundësive të mundshme të financimit dhe asistencës teknike nga donatorët ose mjete të tjera për zbatimin e programeve të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

1.2 Qëllimi dhe objektivat

Ky kapitull përshkruan shkurtimisht objektivat dhe qëllimet e hartimit të PVEE-së (p.sh. PVEE-ja ka si qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor në mënyrë që secili prej institucioneve të qeverisjes vendore të përcaktojë kontributin e saj kundrejt objektivave të përgjithshëm kombëtarë, duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit gjatë të gjithë ciklit të shfrytëzimit të burimeve energjetike në territorin e çdo pushtetit vendor.) Ndër të tjera, ky kapitull duhet të përmbledhë:

Objektivat e përgjithshëm të PVEE-së:

- përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në anën e konsumit final të energjisë (ndërtesa, shërbime dhe aktivitete të tjera të njësisë së qeverisjes vendore);

- promovimin e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për qytetarët dhe kompanitë dhe format e tjera të aktivitetit ekonomik në nivel komunal, dhe



- përmbushjen e detyrimeve të njësisë së qeverisjes vendore në përputhje me PKEK-un, ligjin nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” dhe ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”.

Përveç objektivave të përgjithshëm të programit, duhet të përcaktohen edhe një sërë objektivash individuale. Objektivat individuale mund të përfshijnë gjithashtu detyra specifike (p.sh. rehabilitimi energjetik i të gjitha ndërtesave me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej më shumë se 250 m²). Qëllimet dhe detyrat individuale, për aq sa është e mundur, duhet të jenë:

- specifike (të mirëpërcaktuara);
- të matshme (p.sh. m² ndërtesa të rehabilituara në kuadër të rritjes së efikasitetit të energjisë, kursimet e planifikuara të energjisë të shprehura në kWh ose në % etj.);
- i realizueshëm;
- realiste (duke pasur parasysh burimet dhe asetet që mund të jenë në dispozicion);
- të kufizuar në kohë (afati duhet të jetë i përcaktuar).

Objektivat e përcaktuar me kujdes asistojnë në zgjedhjen e masave që duhet ti jepet prioritet dhe i japin programit konsistencën e brendshme të kërkuar. Duhet të parashikohen masa të përshtatshme për të arritur secilin qëllim, si dhe që secila masë e propozuar e efikasitetit të energjisë duhet të kontribuojë në arritjen e një ose më shumë objektivave. Çdo masë duhet të jetë e matshme dhe treguesit lidhur me energjinë e kursyer, emetimet e mënjanuara të gazeve me efekt serra etj., duhet të identifikohen në çdo rast të propozuar.

1.3 Zbatimi dhe monitorimi

Ky kapitull paraqet strukturën organizative për zbatimin dhe monitorimin e programeve të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Struktura

organizative mund të përfshijë shërbimet e njësisë së qeverisjes vendore, si dhe subjektet/aktorë të tjerë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çështjeve të mëposhtme:

- përzgjedhja e subjekteve që do të përfshihen në zbatimin e PVEE-së (njësi të qeverisjes vendore, agjenci, njësi të qeverisjes qendrore, aktorë të tregut, si dhe pjesëmarrës të tjerë);
- burimet dhe mënyra e financimit.
- përcaktimi i përgjegjësiave për koordinimin e zbatimit të planit (struktura organizative, grupet e punës, caktimi i përgjegjësiave për koordinimin e përgjithshëm të zbatimit, përgjegjësitë dhe rolet e caktuara që u caktohen strukturave/njësive të ndryshme organizative etj.);
- krijimi i skemave të monitorimit të programeve (përgjegjësitë e monitorimit, bordet drejtuese dhe këshillimore, procedurat dhe metodologjitë e monitorimit);
- paraqitja e strukturës organizative në mënyrë skematike ku të pozicionohen drejtoritë përkatëse sipas hierarkisë dhe të evidentohet dukshëm struktura përkatëse për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e PVEE-së. Paraqitja skematike duhet të tregojë qartë mënyrën e përfundimit të informacionit ndërmjet njësive të qeverisjes vendore (si drejtuese e projektit) dhe institucioneve dhe/ose ndërmarrjeve në varësi.

2. STATUSI AKTUAL NË KONSUMIN E ENERGISË DHE EFIÇENCËN E ENERGISË

2.1 Objektet dhe aktivitetet/ shërbimet e njësive të qeverisjes vendore

2.1.1 Vështrim i përgjithshëm i konsumit të energjisë

[Përshkrim i shkurtër i përdorimit të energjisë në njësinë e qeverisjes vendore]

Bartësi i Energjisë	Konsumi vjetor i energjisë		Kostoja vjetore e energjisë [Lekë]
	Njësia	Sasia	
Elektricitet	MWh		
Qymyr/ linjit	ton		
Naftë	ton		
Naftë e lehtë – karburant i lehtë diesel - Diesel	m ³		
Gaz i lëngshëm i naftës - LPG	m ³		
Benzin	m ³		
Druri	m ³		
Peleta druri, briketa dhe copa druri	ton		
NË TOTAL	1000 kWh		

Kolona 100: Totali i flukseve hyrëse (inflow)

Në kolonën 100, në rreshtin “Totali i ekspozimeve” paraqitet shuma e totalit të flukseve dalëse të kolonës 090 të po të njëjtës klasë ekspozimesh dhe flukset dalëse të formularëve të klasave të tjera të ekspozimeve, si rezultat i marrjes

në konsideratë të mbrojtjes së financuar dhe të pafinancuar të kredisë (sipas neneve 54, 94 dhe 95 të rregullores), emetuesi dhe ofruesi i të cilave klasifikohen në klasën e ekspozimit, që i përket formularit që po plotësohet.

Shuma e paraqitur në kolonën 100, në rreshtin total, ndahet sipas rreshtave individualë, duke marrë parasysh:

- llojin e ekspozimit që sigurohet nga mbrojtja e financuar ose e pafinancuar, emetuesit dhe ofruesit e të cilëve janë të klasifikuar në klasën e ekspozimit të formularit që po plotësohet;

- peshën e ponderimit të përcaktuar për mbrojtjen e financuar dhe të pafinancuar të kredisë.

Kolona 110: Ekspozimi neto pas efektit të zëvendësimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit

Në këtë kolonë banka paraqet shumën e ekspozimeve neto, pasi është marrë në konsideratë shuma e flukseve hyrëse dhe dalëse nga aplikimi i mbrojtjes së kredisë me efekt zëvendësues mbi ekspozimet, që llogaritet duke zbritur nga ekspozimet neto në kolonën 040, shumën e flukseve dalëse në kolonën 090 dhe duke shtuar shumën e flukseve hyrëse në kolonën 100.

Kolonat 120 deri në 140: Metodat e zbutjes së rrezikut të kredisë që prekin vlerën e ekspozimit: Mbrojtja e financuar e kredisë, metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar.

Nenet 59–67 të rregullores, përfshirë edhe *Credit linked notes*.

Kolonat 120 deri në 140 i referohen llogaritjes së vlerës së rregulluar të ekspozimit dhe mbrojtjes së financuar të kredisë.

Kolona 120: Rregullimet e luhatshmërisë së ekspozimit

Banka paraqet rregullimin e luhatshmërisë së ekspozimit të llogaritur sipas formulës $(E_{VA} - E) = E \times H_E$

Kolona 130: Kolaterali financiar: Vlera e rregulluar (C_{VAM})

Banka paraqet vlerën e kolateralit financiar të llogaritur sipas nenit 59, pika 3 sipas formulës: $C_{VAM} = C \times (1 - H_C - H_{FX}) \times (t - t^*) / (T - t^*)$.

Kolona 140 – prej të cilit: Rregullimet e luhatshmërisë dhe të maturitetit

Banka paraqet rregullimet e luhatshmërisë dhe të mospërputhjes së maturitetit të llogaritur me anë të formulës $(C_{VAM} - C) = C \times [(1 - H_C - H_{FX}) \times (t -$



$t^*)/(T-t^*) - 1]$, ku efekti i rregullimeve të luhatshmërisë llogaritet me formulën $(C_{VA} - C) = C \times [(1-H_C-H_{FX} - 1]$ dhe efekti i rregullimeve për mospërputhje të maturitetit me anë të formulës $(C_{VAM} - C_{VA}) = C \times (1-H_C-H_{FX}) \times [(t-t^*)/(T-t^*) - 1]$.

Kolona 150: Vlera e ekspozimit të rregulluar plotësisht (E^)*

Banka paraqet vlerën e rregulluar plotësisht të ekspozimit, e cila merr në konsideratë luhatshmërinë e ekspozimit dhe efektet e kolateralit financiar, sipas nenit 74 dhe 59, pika 1. Kjo vlerë llogaritet duke i shtuar shumës në kolonën 110 atë të kolonës 120 dhe duke i zbritur shumën në kolonën 130.

Kolonat 160–190: Ndarja e vlerës së ekspozimit të rregulluar plotësisht të zërave jashtë bilancit, sipas faktorëve të konvertimit

- Në kolonën 0% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 150 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si zëra pa rrezik, sipas aneksit 2 “Klasifikimi i zërave jashtë bilancit” të rregullores.

- Në kolonën 20% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 150 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si zëra me rrezik të ulët, sipas aneksit 2 “Klasifikimi i zërave jashtë bilancit” të rregullores.

- Në kolonën 50% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 150 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si zëra me rrezik të mesëm, sipas aneksit 2 “Klasifikimi i zërave jashtë bilancit” të rregullores.

- Në kolonën 100% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 150 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si zëra me rrezik të lartë, sipas aneksit 2, “Klasifikimi i zërave jashtë bilancit” të rregullores.

Vlerat e përfshira në kolonat 160–190, në rreshtin “Totali i ekspozimeve” duhet të jenë të barabarta me vlerat e përfshira në pikëprerjen e rreshtit 030 “Zërat jashtë bilancit”, me këto kolona.

Kolona 200: Vlera e ekspozimit

Në këtë kolonë, bankat paraqesin vlerën neto të ekspozimit, pasi kanë marrë në konsideratë efektet e mbrojtjes së kredisë dhe faktorët e konvertimit për zërat jashtë bilancit. Për llogaritjen e vlerës së ekspozimit për zërat jashtë bilancit nga kolona 150 zbriten totali i kolonës 160, 80% e shumës së kolonës 170, 50 % e shumës së kolonës 180. Për

tipat e tjerë të ekspozimit, shuma në kolonën 200 është e barabartë me shumën në kolonën 150.

Vlera e paraqitur në këtë kolonë, në pikëprerjen me rreshtin totali i ekspozimeve, është e barabartë me shumën e rreshtave 020, 030, 040, 060, të po kësaj kolone.

Kolona 210: Nga të cilat: Të lidhura me rrezikun e kredisë së kundërpartisë

Në këtë kolonë bankat plotësojnë një pjesë të shumës së reflektuar në kolonën 200, e cila është e lidhur me ekspozime të lindura nga derivativët, transaksionet repo të letrave me vlerë apo të mallrave, marrëveshjet e huadhënies apo të huamarrjes së letrave me vlerë apo mallrave, transaksionet e huadhënies me marzhe dhe marrëveshjet me afat të gjatë shlyerjeje.

Kolona 220: Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, para aplikimit të faktorit mbështetës për SME-në

Bankat, për vlerat e ekspozimeve nga kolona 200 përcaktojnë një peshë rreziku, mbështetur në cilësinë e kredisë.

Kolona 230: Shuma e rregulluar e ekspozimeve të ponderuara me rrezik, si rrjedhojë e faktorit mbështetës për SME-në

Në këtë kolonë zbritet diferenca e shumës së ekspozimeve të ponderuara me rrezik për ekspozimet ndaj SME-ve jo me probleme (RWEA) të llogaritura në përputhje me kërkesat e kreut III të rregullores, me RWEA*, siç parashikohet në nenin 20/1, pika 1 të rregullores.

Kjo kolonë do të plotësohet vetëm për klasat “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolave me pakicë (*retail*)”, ose “Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme”, si dhe në formularin përmbledhës të të gjitha klasave të ekspozimeve.

Kolona 240: Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, pas aplikimit të faktorit mbështetës të SME-së

Vlera në këtë kolonë do të jetë diferenca e vlerave të kolonave 220 dhe 230.

Kjo kolonë do të plotësohet vetëm për klasat “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolave me pakicë (*retail*)”, ose “Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme”, si dhe në formularin përmbledhës të të gjitha klasave të ekspozimeve.



Kolona 250: Nga të cilat: me vlerësim të cilësisë së kredisë nga një ECAI e emëruar

Në këtë kolonë do të pasqyrohet ajo pjesë e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, për llogaritjen e të cilave bankat kanë përdorur peshat e bazuara në vlerësimet e cilësisë së kredisë të kundërpartisë të emetuara nga një ECAI e emëruar, të parashikuara përkatësisht në shkronjat: “a” deri në “d”, “f”, “g”, “g/1”, “i”, “n” dhe “o”.

Kolona 260: Nga të cilat: me cilësi të kredisë të derivuar nga cilësia e kredisë së qeverisë qendrore

Në këtë kolonë do të pasqyrohet ajo pjesë e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, për llogaritjen e të cilave bankat kanë përdorur peshat e bazuara në vlerësimet e cilësisë së kredisë të qeverisë qendrore, të parashikuara përkatësisht në shkronjat: “b” deri në “d”, “f”, “g”, “i” dhe “n”.

2.1.3 Përmbajtja e rreshtave

Rreshti 010: Totali i ekspozimeve

Në rreshtin “Totali i ekspozimeve” bankat raportojnë vlerën totale sipas kolonave individuale, vlerë kjo e cila prezanton shumën e kolonave individuale përkundrejt llojit të ekspozimit ose të peshës së rrezikut.

Rreshti 011: Nga të cilat: ekspozime ndaj SME

Ky rresht plotësohet për klasat “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolave me pakicë (retail)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme” dhe “Ekspozime (kredi) me probleme”, si dhe në formularin përmbledhës të të gjitha klasave të ekspozimeve.

Rreshti 012: Nga të cilat: ekspozime ndaj SME të trajtuar me faktorë mbështetës

Ky rresht plotësohet për klasat “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolave me pakicë (retail)”, “Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme”, si dhe në formularin përmbledhës të të gjitha klasave të ekspozimeve.

Rreshtat 020–060: Ndaj e ekspozimeve totale sipas llojit të ekspozimit:

Shuma e vlerës të ekspozimeve që paraqitet në kolonën 040, në rreshtin “Totali i ekspozimeve” ndahet sipas tipit të ekspozimeve si në vijim:

- Zërat e bilancit: janë zërat që nuk përfshihen në

asnjë nga tipat e tjera të ekspozimit. Ekspozimet e lindura nga shlyerjet jo-DVP, edhe pse nuk janë zëra bilanci pasqyrohen në këtë rresht. Ekspozimet që janë zëra bilanci dhe trajtohen si transaksione të financimit të letrave me vlerë dhe si derivativë apo transaksione me afat të gjatë shlyerje nuk përfshihen në këtë rresht, por përkatësisht në rreshtat 040 dhe 060.

- Zërat jashtë bilancit: zërat e përcaktuar në aneksin 2 të rregullores. Ekspozimet që janë zëra jashtë bilancit dhe trajtohen si transaksione të financimit të letrave me vlerë dhe si derivativë apo transaksione me afat të gjatë shlyerje nuk përfshihen në këtë rresht, por përkatësisht në rreshtat 040 dhe 060.

- Transaksionet e financimit të letrave me vlerë (këtu përfshihen transaksionet repo, transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies të letrave me vlerë dhe mallrave, transaksionet e huadhënies me marzhe si edhe vlera E* e marrëveshjeve kuadër të netimit të lidhura me të tilla transaksione).

- Derivatvë dhe transaksionet me afat të gjatë shlyerje: Derivatvë, siç specifikohet në aneksin IV të rregullores dhe transaksionet me afat të gjatë shlyerje, siç përcaktohen në nenin 4, shkronja “d”, pika 66.

Rreshtat 090-210: Ndaj e ekspozimeve totale sipas peshave të rrezikut

Shuma e vlerës të ekspozimeve që paraqitet në qelizën që formohet nga prerja e kolonës 040 me rreshtin “Totali i ekspozimeve”, ndahet sipas peshave të rrezikut të specifikuar në: 0%, 10%, 20%, 35%, 50%, 75%, 85%, 100%, 125%, 150%, 200%, 250% 1250%, pesha të tjera).

Rreshtat 220-240: Ndaj e ekspozimeve totale sipas metodës së SIK-së

Këto rreshta do të plotësohen vetëm për klasën e ekspozimeve ndaj Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK), siç parashikohet në nenet 28, 28/1, 28/2 dhe 28/3 të rregullores.

2.2 FORMULARI CR SEC SA-TITULLZIMI

2.2.1 Të përgjithshme

Kur banka është origjinuese e titullzimit, ajo plotëson informacionin përkatës në formularin CR SEC SA për ekspozimet e lidhura me transaksionet e titullzimit, për të gjitha titullzimet për të cilat njihet transferimi i një pjese të konsiderueshme të rrezikut të kredisë. Kur banka është në rolin e investuesit, duhet të raportohen të gjitha ekspozimet. Ky formular plotësohet në mënyrë të veçantë për



ekspozimet e lidhura me titullzimet tradicionale dhe ato sintetike që mbahen në librin e bankës, të cilën e përcaktojnë në fushën “Lloji i titullzimit”.

Raportimi varet nga roli që marrin bankat në procesin e titullzimit. Për këtë arsye, raportimi i zërave në formular ndryshon në varësi të faktit nëse banka është në rolin e origjinuesit, investuesit apo sponsorit.

Në fushën ECAI e emëruar, bankat pasqyrojnë emrin e të gjitha ECAI-ve të emëruara për vlerësimin e të tilla ekspozimeve.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe. Ky formular raportohet çdo tremujor.

2.2.2 Përmbajtja e kolonave

Formulari CR SEC SA përmban 36 kolona, përbërja e të cilave është si më poshtë:

Kolona 010: Shuma totale e ekspozimeve të titullzuara të origjinuara

Kjo kolonë plotësohet vetëm nga bankat që kanë rolin e origjinuesit në një titullzim. Në këtë kolonë, bankat plotësojnë tepricën (*outstanding amount*) në datën e raportimit, të të gjitha pozicioneve të titullzuara të origjinuara gjatë transaksioneve të titullzimit, pavarësisht se kush i mban pozicionet.

Kështu, bankat raportojnë si ekspozimet e titullzuara në bilanc (obligacionet, obligacionet e varura), ashtu edhe ekspozimet jashtë bilancit (linjat e varura të kredisë, lehtësirat e likuiditetit dhe derivativët financiarë), që kanë origjinuar gjatë procesit të titullzimit.

Në rastin e një titullzimi tradicional ku origjinuesi nuk mban ndonjë pozicion, origjinuesi nuk do ta konsiderojë këtë titullzim për efekt raportimi. Për këtë qëllim, pozicioni i titullzimit i mbajtur nga origjinuesi do të përfshijë klauzolat e amortizimit të hershëm, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 63, në titullzimin e ekspozimeve qarkulluese.

Kolonat 020-040: Titullzimi sintetik – Mbrojtja e kredisë së ekspozimeve të titullzuara

Kolonat 020-040 i referohen mbrojtjes së kredisë të një titullzimi sintetik, me anë të së cilit arrihet segmentimi (transhing) i ekspozimeve të titullzuara. Vetëm bankat origjinuese në një titullzim sintetik i plotësojnë këto kolona. Mbrojtja e kredisë nuk përfshin rregullimet si rezultat i mospërputhjeve në maturitet, sipas kërkesave të neneve 106 dhe 107 të rregullores.

Kolona 020 dhe 030 i referohen mbrojtjes së financiar dhe të pafinancuar të kredisë.

Kolona 020 – Mbrojtja e financiar e kredisë (CVA)

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së financiar të kredisë siç përcaktohet në nenin 59 të rregullores. Për kolateralin financiar, bankat mund të përdorin vetëm metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar. Për këtë arsye vlera e kolateralit në këtë kolonë paraqitet e rregulluar për luhatshmërinë dhe mospërputhjet në maturitet, siç përcaktohet në nenin 59. *Credit linked notes* trajtohen si mbrojtje e financiar e kredisë sipas nenit 90, pika 2.

Kolona 030: Mbrojtja e pafinancuar e kredisë: Vlera e rregulluar (G*)

Sipas rregullit të përgjithshëm për “flukset hyrëse” dhe “flukset dalëse”, shumat e raportuara në këtë kolonë do të shfaqen si “flukse hyrëse” në formularin përkatës të rrezikut të kredisë (CR SA) dhe në klasën e ekspozimit të cilës banka raportuese i shpërndan ofruesin e mbrojtjes (d.m.th. pala e tretë tek e cila transferohet segmenti (transhi) me anë të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë).

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë të rregulluar për çdo mospërputhje monedhash (G*), sipas nenit 91, pika 1.

Kolona 040: Vlera nominale (notional) e mbajtur ose e riblerë e mbrojtjes së kredisë

Bankat raportojnë në këtë kolonë, vlerat nominale të mbrojtjes së kredisë, që origjinuesi si blerës i kolateralit mban ose riblen nga ofruesit e kolateralit. Efektet e rregullimeve të luhatshmërisë siç përcaktohen në nenet 58 dhe 59 të rregullores, nuk merren në konsideratë për llogaritjen e vlerës të mbajtur apo të riblerë të mbrojtjes së kredisë.

Kolona 050: Pozicionet e titullzimit: Ekspozimi origjinal para faktorëve të konvertimit

Bankat plotësojnë vlerën kontabël të pozicioneve individuale të titullzuara, të llogaritur në përputhje me nenin 103, pika 1 dhe 2, pa aplikuar rregullimet e vlerës apo provigjonet dhe faktorët e konvertimit, dhe pa aplikuar zbritjet e pakthyeshme nga çmimi i blerjes së ekspozimeve të titullzuara, siç përcaktohet në nenin 103, pika 1, shkronja “d” dhe pa aplikuar rregullimet e vlerës apo provigjonet për pozicionet e titullzimit. Origjinuesi, i cili përdor titullzimin sintetik në formën e zërave të bilancit dhe/ose “interesit të investitorit”, e llogarit pozicionin sipas kolonave 010-020-030+040. Kështu, vlera e ekspozimit plotësohet pasi janë marrë në



konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse si rezultat i mbrojtjes së kredisë me anë të të cilave është arritur segmentimi (*transhing*).

Netimi është i rëndësishëm vetëm në rast të kontratave derivative të shumëfishta të ofruara tek i njëjti entitet me qëllim të posaçëm titullzimi (SSPE).

Kolona 060: Rregullimet e vlerës dhe provigjionet

Plotësohet shuma e rregullimeve të vlerës dhe provigjioneve për zërat e bilancit dhe jashtë bilancit vetëm për pozicionet e titullzimit, në përputhje me nenin 103. Nuk do të konsiderohet rregullimi i vlerës për ekspozimet e titullzuara.

Kolona 070: Vlera neto e ekspozimeve (pas rregullimeve të vlerës dhe provigjioneve)

Kjo kolonë do të përfshijë vlerën e ekspozimit në pozicionet e titullzimit të llogaritura në përputhje me nenin 103, pikat 1 dhe 2, neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjionet, pa aplikuar faktorët e konvertimit dhe zbritjet e pakthyeshme nga çmimi i blerjes të ekspozimeve të titullzuara, siç përcaktohet në nenin 103, dhe neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjionet për pozicionin e titullzimit. Vlera neto e ekspozimeve llogaritet si diferencë e kolonës 050 dhe 060, pa aplikuar faktorët e konvertimit.

Kolonat 080–110: Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit

Bankat do të raportojnë në kolonat 080–110, informacion mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që reduktojnë rrezikun e kredisë së ekspozimeve, si rezultat i efektit të zëvendësimit të ekspozimit, ku pesha e rrezikut për pjesën e mbrojtur zëvendësohet me peshën e rrezikut të kolateralit (që do të thotë ofruesi i kolateralit). Kolaterali që ka efekt në vlerën e ekspozimit (nëse përdoret si teknikë e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit), do të kufizohet në vlerën e ekspozimit.

Kolona 080: Mbrojtja e pafinancuar e kredisë - Vlera e rregulluar (Ga)

Bankat plotësojnë vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, të rregulluar për çdo mospërputhje maturiteti dhe monedhe, sipas neneve 90 deri në 92 të rregullores.

Kolona 090: Mbrojtja e financuar e kredisë

Mbrojtja e financuar e kredisë, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “b”, pika 25 dhe referuar në nenin 104, pika 2 dhe siç rregullohet në nenet 49,

68 dhe 77. Për kolateralin financiar, kjo kolonë plotësohet vetëm nga bankat që përdorin metodën e thjeshtë të kolateralit financiar, sipas neneve 53–56 të rregullores.

Credit linked notes dhe marrëveshjet e netimit në bilanc do të trajtohen si kolateral në *cash* sipas nenit 90, pika 2, dhe nenit 70 të rregullores.

Kolona 100: Totali i flukseve dalëse

Nenet 54 dhe 95 të rregullores.

Plotësohet shuma e kolateralizuar për secilin prej roleve që ka një bankë në titullzim (originues, investitor etj.). Flukset dalëse korrespondojnë me pjesën e mbuluar të kolonës “Vlera neto e ekspozimeve (pas rregullimeve të vlerës dhe provigjioneve)” që zbritet nga klasa e ekspozimit të debitorit/huamarrësit (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit) dhe për rrjedhojë i caktohet klasës së ekspozimit (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit) të ofruesit të mbrojtjes.

E njëjta shumë do të plotësohet si flukse hyrëse për të njëjtin rol (originues, investues dhe sponsor) në klasën e ekspozimit të ofruesit të mbrojtjes (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit).

Kolona 110: Totali i flukseve hyrëse

Pozicionet e titullzimit që janë letra me vlerë të borxhit dhe janë përdorur si kolateral i pranuar financiar, në përputhje me nenin 49, pika 1 të rregullores dhe kur përdoret metoda e thjeshtë e kolateralit financiar, duhet të raportohen si flukse hyrëse në këtë kolonë.

Kolona 120: Ekspozimi neto pas efektit të zëvendësimit si rezultat i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit

Në këtë kolonë plotësohet shuma e ekspozimit të caktuar në klasën përkatëse të ekspozimit dhe të peshës së rrezikut, pasi janë marrë në konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse si rezultat i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit, e cila llogaritet duke zbritur nga kolona 070, shumën totale në kolonën 100 dhe duke shtuar shumën e kolonës 110 (070-100+110).

Kolona 130: Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që ndikojnë në vlerën e ekspozimit: Vlera e rregulluar me mbrojtjen e financuar të kredisë, sipas metodës gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar

Nenet 58–67 të rregullores.



Vlerat e raportuara duhet të përfshijnë edhe *credit linked notes*.

Kolona 140: *Vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E*): llogaritet si (120–130)*

Në këtë kolonë raportohet vlera e ekspozimit të pozicioneve të titullzimit, llogaritur në përputhje me nenin 103, por pa aplikuar faktorët e konvertimit të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 103.

Kolona 150 – nga e cila: subjekt i një faktori konvertimi prej 0%

Neni 103, pika 1, shkronja “b”.

Për qëllime raportimi, vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E*) do të raportohet për faktorin e konvertimit prej 0%.

Kolona 160: *Zbritje të pakthyeshme nga çmimi i blerjes*

Në përputhje me nenin 103, pika 1, shkronja “d” e rregullores, një bankë origjinuese mund të zbresë nga vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi të cilit i është caktuar një peshë rreziku 1250%, çdo zbritje të pakthyeshme nga çmimi i blerjes që lidhet me ekspozimin bazë, në masën që një zbritje e tillë ka shkaktuar reduktimin e kapitalit rregullator.

Kolona 170: *Rregullime specifike të rrezikut të kredisë të ekspozimeve bazë*

Në përputhje me nenin 103, pika 1, shkronja “d” e rregullores, një bankë origjinuese mund të zbresë nga vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi, të cilit i është caktuar një peshë rreziku 1250% ose është zbritur nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e rezervave për mbulimin e humbjeve të ekspozimeve bazë, në përputhje me nenin 9 të rregullores.

Kolona 180: *Vlera e ekspozimit*

Në këtë kolonë plotësohet vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 103 të rregullores.

Kolona 190: *Vlera e ekspozimit që zbritet nga kapitali rregullator*

Në përputhje me nenin 99, pika 1, shkronja “b”, nenin 100, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 108, pika 1 të rregullores, plotësohet vlera e pozicioneve të titullzuara, të cilave iu është caktuar një peshë rreziku 1250%, të cilat banka nuk i përfshin në shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, por i zbret nga kapitali rregullator, sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.

Kolona 200: *Vlera e ekspozimit subjekt i ponderimit me rrezik*

Bankat plotësojnë në këtë kolonë vlerën e ekspozimit të llogaritur si diferencë e kolonave 180 dhe 190.

Kolonat 210–260: *Ndarja e ekspozimeve subjekt i ponderimit me rrezik, sipas peshave të rrezikut*

Ekspozimet ndahen sipas klasave të rrezikut.

Për peshën e rrezikut 1250% (W e panjohur), neni 113, pika 2 e rregullores parashikon që pozicionet në titullzim do të ponderohen me 1250%, kur banka nuk njeh vonesat për 5% ose më pak të ekspozimeve bazë në grupin e ekspozimeve bazë (*pool*).

Kolona 270: *Vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik për rastet e tjera (pesha e rrezikut 1250%)*

Në këtë kolonë plotësohet vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik, në rastet kur nuk aplikohet asnjë nga metodat (SEC-SA apo SEC-ERBA) dhe pozicioneve në titullzim i caktohet një peshë rreziku prej 1250%, në përputhje me parashikimet në nenin 109, pika 6 të rregullores.

Kolona 280: *Vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik metoda SEC-SA*

Në këtë kolonë plotësohet shuma totale e ponderuar me rrezik, e llogaritur në përputhje me nënkreun II të kreut V të rregullores, si shumë e prodhimeve të ekspozimeve individuale prej kolonave 210–260 dhe peshave të rrezikut korresponduese, para rregullimeve për mospërputhjet e maturitetit ose kërkesave të kujdesshme, dhe duke përjashtuar çdo ekspozim të ponderuar me rrezik që i korrespondon ekspozimeve të rishpërndara me anë të flukseve dalëse (*outflow*) në formularët e tjerë.

Kolona 290: *Nga të cilat: Titullzime sintetike*

Për titullzimet sintetike me mospërputhje në maturitet, shuma që do të raportohet në këtë kolonë nuk konsideron mospërputhjet në maturitet.

Kolona 300: *Rregullime të vlerës së ekspozimit të ponderuar me rrezik për mospërputhjet në maturitet*

Mospërputhjet e maturitetit për titullzimet sintetike RW*-RW_{SP}, midis mbrojtjes së kredisë me anë të së cilës është arritur transferimi i rrezikut dhe ekspozimeve të titullzuara, llogariten në përputhje me nenin 107 të rregullores. Rregullimet e vlerës së ekspozimit të ponderuar me rrezik për mospërputhjet në maturitet përfshihen në këtë kolonë, me përjashtim të rasteve kur segmentet (transhet) janë subjekt i një peshe rreziku prej



1250%, ku shuma që duhet të raportohet është 0. Shuma e RWSP përfshin jo vetëm shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezik të raportuara nën kolonën 280, por përfshin edhe shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që i korrespondojnë ekspozimeve të shpërndara nëpërmjet flukseve dalëse (*outflow*) në formularët e tjerë.

Kolona 310: Rregullime të vlerës së ekspozimit kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nënkreun III të kreut V të rregullores

Në përputhje me nenin 119 të rregullores, kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nënkreun III të kreut V të rregullores, Banka e Shqipërisë mund të vendosë proporcionalisht, një peshë rreziku shtesë prej jo më pak se 250% të peshës së rrezikut, por jo më të lartë se 1250%, që do t'i aplikohet pozicionit përkatës të titullzimit, në mënyrën e përcaktuar në kreun V të rregullores.

Kolona 320: Vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik para aplikimit të peshës maksimale të rrezikut

Shuma totale e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për pozicionet e titullzuara, e llogaritur në përputhje me nënkreun II të kreut V të rregullores, përpara aplikimit të kufizimeve të specifikuara në nenin 115 dhe 116.

Kolona 330: Reduktime për shkak të peshës maksimale të rrezikut

Në përputhje me nenin 115 të rregullores, një bankë që ka dijeni në çdo moment për përbërjen e ekspozimeve bazë, i cakton pozicioneve *senior* të titullzimit, një peshë maksimale rreziku të barabartë me peshën mesatare të ponderuar të rrezikut të ekspozimeve të cilat do t'u aplikoheshin ekspozimeve bazë, sikur këto ekspozime bazë të mos ishin titullzuar.

Kolona 340: Reduktime për shkak të aplikimit të kërkesës maksimale për kapital

Në përputhje me nenin 116 të rregullores, një bankë origjinuese ose një sponsor që përdor metodën standarde (SEC-SA) ose metodën e bazuar në vlerësimin e jashtëm (SEC-ERBA) mund të aplikojë një kërkesë maksimale për kapital për pozicionin e titullzimit, të barabartë me kërkesën për kapital që do të llogaritej në përputhje me kreun III të rregullores, në lidhje me ekspozimet bazë, sikur këto ekspozime bazë të mos ishin titullzuar.

Kolona 350: Shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik

Në këtë kolonë raportohet shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik, e përlogaritur në përputhje me kërkesat e nënkreut II të kreut V të rregullores, duke konsideruar peshën totale të rrezikut të përcaktuar në nenin 102, pika 6.

Kolona 350 llogaritet duke zbritur nga kolona 320, kolonat 330 dhe 340 (320–330–340).

Kolona 360: Zëra memorandumi: shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik që i korrespondon flukseve dalëse nga titullzimet të klasat e tjera të ekspozimeve.

Në këtë kolonë raportohet shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që rrjedh nga ekspozimet e rishpërndara tek ofruesi i zbutjes së rrezikut, dhe si të tilla që janë raportuar në formularin përkatës dhe që janë konsideruar në përlogaritjen e peshës maksimale të rrezikut për pozicionet e titullzimit.

Bankat duhet të raportojnë ekspozimet në titullzime sipas kolonave dhe të analizojnë fushat që mbulohen nga një aktivitet i tillë nëpër rreshta sipas rolit që merret përsipër në titullzim.

2.2.3 Përmbajtja e rreshtave

Formulari CR SEC SA përmban 15 rreshta, të cilët janë të ndarë në tri grupe kryesore, që mbledhin të dhëna mbi ekspozimet e origjinuara/sponsorizuara/të mbajtura ose të blera nga origjinuesit, investuesit dhe sponsorët. Për secilin prej tyre, informacioni do të ndahet në zëra të bilancit, zëra jashtë bilancit dhe derivativë, si dhe nëse është rritullzim.

Rreshti 010: Ekspozimi total

Vlera në rreshtin 10 duhet të jetë e barabartë me shumën e ekspozimeve totale të bankës në titullzime dhe rritullzime. Ky rresht përmbledh të gjithë informacionin e raportuar nga origjinuesit, sponsorët dhe investuesit në rreshtat e mëposhtëm.

Rreshti 020: Pozicione titullzimi

Në këtë rresht raportohet shuma totale e pozicioneve në titullzim, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 47, të cilat nuk janë rritullzuar siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 45/4 të rregullores.

Rreshti 030, 070, 0110, 0150: Pozicione rritullzimi

Në këto rreshta raportohet shuma totale e pozicioneve në rritullzim.

Rreshti 040: Origjinuesi: Ekspozimi total

Në këtë rresht përmbledhet informacioni mbi ekspozimet e titullzuara për zërat në bilanc, si dhe



ekspozimet jashtë bilancit dhe derivativët, së bashku me pozicionet e rititullzimit për të cilat banka është në rolin e origjinuesit, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 48 të rregullores.

Rreshtat 050, 090, 0130: Pozicione titullzimi: Zërat në bilanc

Në përputhje me nenin 103, pika 1, shkronja “a” të rregullores, vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi të regjistruar në bilanc, do të jetë vlera e tij kontabël pas zbritjes së rezervave për mbulimin e humbjeve për pozicionin e titullzimit, në përputhje me nenin 9 të rregullores.

Rreshtat 060, 0100, 0140 – Pozicione titullzimi: Zërat jashtë bilancit

Këto rreshta përmbledhin informacion mbi pozicionet e titullzimit jashtë bilancit dhe pozicionet e titullzimit që rrjedhin nga instrumente derivative, subjekt i një faktori konvertimi sipas kuadrit rregullativ të titullzimit. Vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi jashtë bilancit është vlera e tij nominale, pasi i zbriten rezervat specifike përkatëse për mbulimin e humbjeve për pozicionin e titullzimit, e shumëzuar me një faktor konvertimi 100%, nëse nuk specifikohet ndryshe.

Pozicionet e titullzimit jashtë bilancit që rrjedhin nga një instrument derivativ i listuar në aneksin 4 të rregullores, do të përcaktohen në përputhje me kreun VI të rregullores. Vlera e ekspozimit për rrezikun e kredisë së kundërpartisë së një instrumenti derivativ të listuar në aneksin 4 do të përcaktohet në përputhje me kreun VI të rregullores.

Për lehtësirat e likuiditetit, angazhimet e kredive dhe paradhëniet *cash*, banka duhet të raportojë shumën e patërhequr.

Për *swap* të normave të interesit dhe kursit të këmbimit, raportohet vlera e ekspozimit e llogaritur sipas nenit 103, pika 1 të rregullores.

Rreshti 080 – Investuesi: Ekspozimi total

Në këtë rresht përmbledhet informacioni mbi ekspozimet e titullzuara për zërat në bilanc, si dhe ekspozimet jashtë bilancit dhe derivativët, së bashku me pozicionet e rititullzimit për të cilat banka është në rolin e investuesit, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 55 të rregullores.

Rreshti 0120 – Sponsorit: Ekspozimi total

Në këtë rresht përmbledhet informacioni mbi ekspozimet e titullzuara për zërat në bilanc, si dhe ekspozimet jashtë bilancit dhe derivativët, së bashku me pozicionet e rititullzimit për të cilat banka është

në rolin e sponsorit, siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “c”, pika 49 të rregullores. Nëse sponsori titullzon, gjithashtu, aktivet e tij, ai duhet të plotësojë rreshtat ku raportohet ekspozimi në rolin e origjinuesit, me informacion mbi aktivet e veta të titullzuara.

Bankat, të cilat kanë investime në titullzime, në këtë formular do të plotësojnë vetëm qelëzat e ngjyrosura me të verdhë.

2.3 FORMULARI CR SEC ERBA-TITULLZIMI

2.3.1 Të përgjithshme

Kur banka është origjinuese e titullzimit, ajo plotëson informacionin përkatës në formularin CR SEC ERBA për ekspozimet e lidhura me transaksionet e titullzimit, për të gjitha titullzimet për të cilat njihet transferimi i një pjese të konsiderueshme të rrezikut të kredisë. Kur banka është në rolin e investuesit duhet të raportohen të gjitha ekspozimet. Ky formular plotësohet në mënyrë të veçantë për ekspozimet e lidhura me titullzimet tradicionale dhe ato sintetike të regjistruara në librin e bankës, të cilën e përcaktojnë në fushën “Lloji i titullzimit”.

Raportimi varet nga roli që marrin bankat në procesin e titullzimit. Për këto arsye raportimi i zërave në formular ndryshon në varësi të faktit, nëse banka është në rolin e origjinuesit, investuesit apo sponsorit.

Në fushën ECAI të emëruar, bankat pasqyrojnë emrin e të gjitha ECAI-ve të emëruara për vlerësimin e të tilla ekspozimeve.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Ky formular raportohet çdo tremujor.

2.3.2 Përmbajtja e kolonave

Formulari CR SEC ERBA përmban 56 kolona përbërja e të cilave është si më poshtë:

Kolona 010: Shuma totale e ekspozimeve të titullzuara të origjinuara

Kjo kolonë plotësohet vetëm nga bankat që kanë rolin e origjinuesit në një titullzim. Në këtë kolonë bankat plotësojnë tepicën (*outstanding amount*) në datën e raportimit, të të gjithë pozicioneve të titullzuara të origjinuara gjatë transaksioneve të titullzimit, pavarësisht se kush i mban pozicionet.

Kështu, bankat raportojnë si ekspozimet e titullzuara në bilanc (obligacionet, obligacionet e varura), ashtu edhe ekspozimet jashtë bilancit (linjat



e varura të kredisë, lehtësirat e likuiditetit dhe derivativët financiarë), që kanë origjinuar gjatë procesit të titullzimit.

Në rastin e një titullzimi tradicional ku origjinuesi nuk mban ndonjë pozicion, origjinuesi nuk do ta konsiderojë këtë titullzim për efekt raportimi. Për këtë qëllim, pozicioni i titullzimit i mbajtur nga origjinuesi do të përfshijë klauzolat e amortizimit të hershëm, siç përcaktohet në neni 4, shkronja “c”, pika 63 të rregullores, në titullzimin e ekspozimeve qarkulluese.

Kolonat 020-040: Titullzimi sintetik – Mbrojtja e kredisë së ekspozimeve të titullzuara

Kolonat 020-040 i referohen mbrojtjes së kredisë të një titullzimi sintetik, me anë të së cilës arrihet segmentimi (*transhing*) i ekspozimeve të titullzuara. Vetëm bankat origjinuese në një titullzim sintetik i plotësojnë këto kolona. Mbrojtja e kredisë nuk përfshin rregullimet si rezultat i mospërputhjeve në maturitet (sipas kërkesave të neneve 106 dhe 107 të rregullores).

Kolona 020 dhe 030 i referohen mbrojtjes së financuar dhe të pafinancuar të kredisë.

Kolona 020: Mbrojtja e financuar e kredisë (CVA)

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së financuar të kredisë siç përcaktohet në nenin 59 të rregullores. Për kolateralin financiar bankat mund të përdorin vetëm metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar. Për këtë arsye, vlera e kolateralit në këtë kolonë paraqitet e rregulluar për luhatshmërinë dhe mospërputhjet në maturitet, siç përcaktohet në nenin 59 të rregullores. *Credit linked notes* trajtohen si mbrojtje e financuar e kredisë sipas nenit 90, pika 2 të rregullores.

Kolona 030: Mbrojtja e pafinancuar e kredisë: Vlera e rregulluar (G)*

Sipas rregullit të përgjithshëm për “flukset hyrëse” dhe “flukset dalëse”, shumat e raportuara në këtë kolonë do të shfaqen si “flukse hyrëse” në formularin përkatës të rrezikut të kredisë (CR SA) dhe në klasën e ekspozimit të së cilës banka raportuese i shpërndan ofruesin e mbrojtjes (d.m.th. pala e tretë tek e cila transferohet segmenti (*transhi*) me anë të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë).

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë të rregulluar për çdo mospërputhje monedhash (G*), sipas nenit 91, pika 1 të rregullores.

Kolona 040: Vlera nominale (notional) e mbajtur ose e riblerë e mbrojtjes së kredisë

Bankat raportojnë në këtë kolonë, vlerat nominale të mbrojtjes së kredisë, që origjinuesi si blerës i kolateralit mban ose riblen nga ofruesit e kolateralit. Efektet e rregullimeve të luhatshmërisë siç përcaktohen në nenet 58 dhe 59 të rregullores, nuk merren në konsideratë për llogaritjen e vlerës së mbajtur apo të riblerë të mbrojtjes së kredisë.

Kolona 050: Pozicionet e titullzimit: Ekspozimi original para faktorëve të konvertimit

Bankat plotësojnë vlerën kontabël të pozicioneve individuale të titullzuara, në përputhje me nenin 103, pikat 1 dhe 2, pa aplikuar rregullimet e vlerës apo provigjonet dhe faktorët e konvertimit, dhe pa aplikuar zbritjet e pakthyeshme nga çmimi i blerjes të ekspozimeve të titullzuara, siç përcaktohet në nenin 103, pika 1, shkronja “d” dhe pa aplikuar rregullimet e vlerës apo provigjonet për pozicionet e titullzimit. Origjinuesi, i cili përdor titullzimin sintetik në formën e zërave të bilancit dhe/ose “interesit të investitorit”, e llogarit pozicionin sipas kolonave 010-020-030+040. Kështu, vlera e ekspozimit plotësohet pasi janë marrë në konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse si rezultat i mbrojtjes së kredisë me anë të të cilave është arritur segmentimi (*transhing*).

Netimi është i rëndësishëm vetëm në rast të kontratave derivative të shumëfishta të ofruara tek i njëjti entitet me qëllim të posaçëm titullzimi (SSPE).

Kolona 060: Rregullimet e vlerës dhe provigjonet

Plotësohet shuma e rregullimeve të vlerës dhe provigjoneve për zërat e bilancit dhe jashtë bilancit vetëm për pozicionet e titullzimit, në përputhje me nenin 103 të rregullores. Nuk do të konsiderohet rregullimi i vlerës për ekspozimet e titullzuara.

Kolona 070: Vlera neto e ekspozimeve (pas rregullimeve të vlerës dhe të provigjoneve)

Kjo kolonë do të përfshijë vlerën e ekspozimit në pozicionet e titullzimit të llogaritura në përputhje me nenin 103, pika 1 dhe 2, neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet, pa aplikuar faktorët e konvertimit dhe zbritjet e pakthyeshme nga çmimi i blerjes të ekspozimeve të titullzuara, siç përcaktohet në nenin 103, dhe neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet për pozicionin e titullzimit. Vlera neto e ekspozimeve llogaritet si diferencë e kolonës 050 dhe 060, pa aplikuar faktorët e konvertimit.

Kolonat 080-110: Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit

Bankat do të raportojnë në kolonat 080–110, informacion mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të



kredisë që reduktojnë rrezikun e kredisë së ekspozimeve, si rezultat i efektit të zëvendësimit të ekspozimit, ku pesha e rrezikut për pjesën e mbrojtur zëvendësohet me peshën e rrezikut të kolateralit (që do të thotë ofruesi i kolateralit). Kolaterali që ka efekt në vlerën e ekspozimit (nëse përdoret si teknikë e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit), do të kufizohet në vlerën e ekspozimit.

Kolona 080: Mbrojtja e pafinancuar e kredisë - Vlera e rregulluar (Ga)

Bankat plotësojnë vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, të rregulluar për çdo mospërputhje maturiteti dhe monedhe, sipas neneve 90 deri në 92 të rregullores.

Kolona 090: Mbrojtja e financuar e kredisë

Mbrojtja e financuar e kredisë siç përcaktohet në nenin 4, shkronja “b”, pika 25 të rregullores dhe referuar në nenin 104, pika 2 dhe siç rregullohet në nenet 49, 68 dhe 77 të rregullores. Për kolateralin financiar, kjo kolonë plotësohet vetëm nga bankat që përdorin metodën e thjeshtë të kolateralit financiar, sipas neneve 53–56 të rregullores.

Credit linked notes dhe marrëveshjet e netimit në bilanc do të trajtohen si kolateral *cash*, sipas nenit 90, pika 2 dhe nenit 70 të rregullores.

Kolona 100: Totali i flukseve dalëse

Nenet 54 dhe 95 të rregullores.

Plotësohet shuma e kolateralizuar për secilin prej roleve që ka një bankë në titullzim (originues, investitor etj.). Flukset dalëse korrespondojnë me pjesën e mbuluar të kolonës “Vlera neto e ekspozimeve (pas rregullimeve të vlerës dhe provigjoneve)”, që zbritet nga klasa e ekspozimit të debitorit/huamarrësit (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit) dhe për rrjedhojë i caktohet klasës së ekspozimit (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit) të ofruesit të mbrojtjes.

E njëjta shumë do të plotësohet si flukse hyrëse për të njëjtin rol (originues, investues dhe sponsor) në klasën e ekspozimit të ofruesit të mbrojtjes (dhe ku është e përshtatshme, pesha e rrezikut ose shkalla e cilësisë së kredisë së debitorit).

Kolona 110: Totali i flukseve hyrëse

Pozicionet e titullzimit që janë letra me vlerë të borxhit dhe janë përdorur si kolateral i pranuar financiar në përputhje me nenin 49, pika 1, të rregullores dhe kur përdoret metoda e thjeshtë e

kolateralit financiar, duhet të raportohen si flukse hyrëse në këtë kolonë.

Kolona 120: Ekspozimi neto pas efektit të zëvendësimit si rezultat i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit

Në këtë kolonë plotësohet shuma e ekspozimit të caktuar në klasën përkatëse të ekspozimit dhe të peshës së rrezikut, pasi janë marrë në konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse si rezultat i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësimi të ekspozimit, e cila llogaritet duke zbritur nga kolona 070, shumën totale në kolonën 100 dhe duke shtuar shumën e kolonës 110 (070-100+110).

Kolona 130: Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që ndikojnë në vlerën e ekspozimit: Vlera e rregulluar me mbrojtjen e financuar të kredisë, sipas metodës gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar

Nenet 58–67 të rregullores.

Vlerat e raportuara duhet të përfshijnë edhe *credit linked notes*.

Kolona 140: Vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E): llogaritet si (120–130).*

Në këtë kolonë raportohet vlera e ekspozimit të pozicioneve të titullzimit, llogaritur në përputhje me nenin 103, por pa aplikuar faktorët e konvertimit të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 103 të rregullores.

Kolona 150: Nga e cila: subjekt i një faktori konvertimi prej 0%

Neni 103, pika 1, shkronja “b”.

Për qëllime raportimi, vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E*) do të raportohet për faktorin e konvertimit prej 0%.

Kolona 160: Zbritje të pakthyeshme nga çmimi i blerjes

Në përputhje me nenin 103, pika 1, shkronja “d” e rregullores, një bankë originuese mund të zbresë nga vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi, të cilit i është caktuar një peshë rreziku 1250%, çdo zbritje të pakthyeshme nga çmimi i blerjes që lidhet me ekspozimin bazë në masën që një zbritje e tillë ka shkaktuar reduktimin e kapitalit rregullator.

Kolona 170: Rregullime specifike të rrezikut të kredisë të ekspozimeve bazë

Në përputhje me nenin 103, pika 1, shkronja “d”, të rregullores, një bankë originuese mund të zbresë nga vlera e ekspozimit të një pozicioni titullzimi, të cilit i është caktuar një peshë rreziku 1250% ose është zbritur nga kapitali bazë i nivelit të parë, shumën e rezervave për mbulimin e humbjeve të ekspozimeve bazë, në përputhje me nenin 9 të rregullores.

*Kolona 180: Vlera e ekspozimit*

Në këtë kolonë plotësohet vlera e ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 103 të rregullores.

Kolona 190: Vlera e ekspozimit që zbritet nga kapitali rregullator

Në përputhje me nenin 99, pika 1, shkronja “b”, nenin 100, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 108, pika 1 të rregullores, plotësohet vlera e pozicioneve të titullzuara, të cilave iu është caktuar një peshë rreziku 1250%, të cilat banka nuk i përfshin në shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, por i zbritet nga kapitali rregullator, sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.

Kolona 200: Vlera e ekspozimit subjekt i ponderimit me rrezik

Bankat plotësojnë në këtë kolonë vlerën e ekspozimit të llogaritur si diferencë e kolonave 180 dhe 190.

Kolonat 210–420: Ndarja e ekspozimeve subjekt i ponderimit me rrezik sipas peshave të rrezikut

Raportimi bazohet në përcaktimet e nenit 114 të rregullores.

Për pozicionet e titullzimit për të cilat mund të përdoret një vlerësim i derivuar, siç parashikohet në nenin 109, pika 2, të rregullores përdoret metoda e bazuar në vlerësimin e jashtëm të kredisë (SEC-ERBA) dhe raportohen si pozicione të vlerësuara.

Ekspozimet subjekt i ponderimit me rrezik do të ndahet në klasa të cilësisë së kredisë, sipas vlerësimit afatshkurtër dhe vlerësimit afatgjatë, sipas përcaktimeve në tabelat 13 dhe 14 të nenit 114 të rregullores.

Kolona 430: Vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik

Në këtë kolonë plotësohet shuma totale e ponderuar me rrezik, e llogaritur në përputhje me nënkreun II të kreut V të rregullores, si shumë e prodhimeve të ekspozimeve individuale prej kolonave 210–420 dhe peshave të rrezikut korresponduese, para rregullimeve për mospërputhjet e maturitetit ose kërkesave të kujdesshme, dhe duke përjashtuar çdo ekspozim të ponderuar me rrezik që i korrespondon ekspozimeve të rishpërndara me anë të flukseve dalëse (*outflow*) në formularët e tjerë.

Kolonat 440–480: Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik: Ndarë sipas arsyes për aplikimin e metodës SEC-ERBA

Për çdo pozicion titullzimi, banka duhet të konsiderojë një nga opsionet e përcaktuara në kolonat 440–480.

Kolona 440: Kredi për automjete, leasing automjeteve dhe leasing pajisjesh

Raportimi do bazohet në kërkesat e nenit 109, pika 2, shkronja “b” të rregullores.

Të gjitha kreditë për automjete, *leasing* automjeteve dhe *leasing* pajisjesh duhet të raportohen në këtë kolonë, edhe nëse ato kualifikohen në parashikimet e nenit 109, pika 2, shkronja “a” të rregullores.

Kolona 450: Mundësia e aplikimit të metodës SEC-ERBA

Raportimi bazohet në kërkesat e nenit 109, pika 3 të rregullores.

Kolona 460: Pozicionet sipas nenit 109, pika 2, shkronja “a”, të rregullores

Raportimi bazohet në kërkesat e nenit 109, pika 2, shkronja “a” të rregullores.

Kolona 470: Pozicionet sipas nenit 109, pika 4 të rregullores

Në këtë kolonë raportohen pozicionet e titullzimit, në rastet kur Banka e Shqipërisë mund të mos lejojë bankën që të aplikojë metodën standarde (SEC-SA), sipas nenit 109, pika 4 të rregullores.

Kolona 480: Përdorimi i hierarkisë së metodave

Pozicionet e titullzimit ku aplikimi i metodës SEC-ERBA bazohet në ndjekjen e hierarkisë së metodave, sipas përcaktimeve në nenin 109, pika 1, të rregullores.

Kolona 490: Nga të cilat: Titullzime sintetike

Për titullzimet sintetike me mospërputhje në maturitet, shuma që do të raportohet në këtë kolonë nuk konsideron mospërputhjet në maturitet.

Kolona 500: Rregullimet e vlerës së ekspozimit të ponderuar me rrezik për mospërputhjet në maturitet

Mospërputhjet e maturitetit për titullzimet sintetike RW*-RW_{Sp}, midis mbrojtjes së kredisë me anë të së cilës është arritur transferimi i rrezikut dhe ekspozimeve të titullzuara, llogariten në përputhje me nenin 107 të rregullores. Rregullimet e vlerës së ekspozimit të ponderuar me rrezik për mospërputhjet në maturitet përfshihen në këtë kolonë, me përjashtim të rasteve kur segmentet (transhet) janë subjekt i një peshe rreziku prej 1250%, ku shuma që duhet të raportohet është 0. Shuma e RW_{Sp} përfshin jo vetëm shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezik të raportuara nën kolonën 430, por përfshin edhe shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që i korrespondojnë ekspozimeve të shpërndara



nëpërmjet flukseve dalëse (*outflow*) në formularët e tjerë.

Kolona 510: Rregullime të vlerës së ekspozimit kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nënkreun III të kreut V të rregullores

Në përputhje me nenin 119 të rregullores, kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nënkreun III të kreut V të rregullores, Banka e Shqipërisë mund të vendosë proporcionalisht, një peshë rreziku shtesë prej jo më pak se 250% të peshës së rrezikut, por jo më të lartë se 1250%, që do t'i aplikohet pozicionit përkatës të titullzimit, në mënyrën e përcaktuar në kreun V të rregullores.

Kolona 520: Vlera e ekspozimit e ponderuar me rrezik para aplikimit të peshës maksimale të rrezikut

Shuma totale e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për pozicionet e titullzuara, e llogaritur në përputhje me nënkreun II të kreut V të rregullores, përpara aplikimit të kufizimeve të specifikuara në nenin 115 dhe 116 të rregullores.

Kolona 530: Reduktime për shkak të peshës maksimale të rrezikut

Në përputhje me nenin 115 të rregullores, një bankë që ka dijeni në çdo moment për përbërjen e ekspozimeve bazë, i cakton pozicioneve senior të titullzimit, një peshë maksimale rreziku të barabartë me peshën mesatare të ponderuar të rrezikut të ekspozimeve të cilat do t'u aplikoheshin ekspozimeve bazë, sikur këto ekspozime bazë të mos ishin titullzuar.

Kolona 540: Reduktime për shkak të aplikimit të kërkesës maksimale për kapital

Në përputhje me nenin 116 të rregullores, një bankë origjinuese ose një sponsor që përdor metodën standarde (SEC-SA) ose metodën e bazuar në vlerësimin e jashtëm (SEC-ERBA) mund të aplikojë një kërkesë maksimale për kapital për pozicionin e titullzimit, të barabartë me kërkesën për kapital që do të llogaritej në përputhje me kreun III të rregullores, në lidhje me ekspozimet bazë, sikur këto ekspozime bazë të mos ishin titullzuar.

Kolona 550: Shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik

Në këtë kolonë raportohet shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik, e përlllogaritur në përputhje me kërkesat e nënkreut II të kreut V të rregullores, duke konsideruar peshën totale të rrezikut të përcaktuar në nenin 102, pika 6 të rregullores.

Kolona 550 llogaritet duke zbritur nga kolona 520, kolonat 530 dhe 540 (520–530–540).

Kolona 560: Zëra memorandumit: shuma totale e ekspozimit e ponderuar me rrezik që i korrespondon flukseve dalëse nga titullzimet të klasat e tjera të ekspozimeve.

Në këtë kolonë raportohet shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që rrjedh nga ekspozimet e rishpërndara të ofruesit i zbutjes së rrezikut, dhe si të tilla që janë raportuar në formularin përkatës dhe që janë konsideruar në përlllogaritjen e peshës maksimale të rrezikut për pozicionet e titullzimit.

Bankat duhet të raportojnë ekspozimet në titullzime sipas kolonave dhe të analizojnë fushat që mbulohen nga një aktivitet i tillë nëpër rreshta sipas rolit që merret përsipër në titullzim.

2.3.3 Përmbajtja e rreshtave

Formulari CR SEC ERBA përmban 39 rreshta. 15 rreshtat e parë (010–0150) janë të ndarë në tri grupe kryesore, që mbledhin të dhëna mbi ekspozimet e origjinuara/të sponsorizuara/të mbajtura ose të blera nga origjinuesit, investuesit dhe sponsorët. Për secilin prej tyre, informacioni do të ndahet në zëra të bilancit, zëra jashtë bilancit dhe derivativë, si dhe nëse ekspozimi është rrititullzim.

Rreshtat 010–0150

Rreshtat 010–0150 të formularit CR SEC ERBA do të plotësohen në të njëjtën mënyrë siç është sqaruar në seksionin 2.2.3, “Përmbajtja e rreshtave” të këtij udhëzuesi, për mënyrën e plotësimit të rreshtave përkatës të formularit CR SEC SA.

Rreshtat 0160–0390: Ndarja e ekspozimeve subjekt i ponderimit me rrezik sipas klasave të rrezikut

Këto rreshta përmbledhin informacion mbi pozicionet aktuale (tepricën e pozicioneve) në datën e raportimit, për të cilat është caktuar një vlerësim rreziku sipas klasave të cilësisë së kredisë, të parashikuara në tabelat 13 dhe 14 të nenit 114 të rregullores, në datën e origjinimit.

Këto rreshta do të plotësohen për kolonat 180–480.

Bankat, të cilat kanë investime në titullzime, në këtë formular do të plotësojnë vetëm qelizat e ngjyrosura me të verdhë.

3. Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut

3.1 FORMULARI MKR SA TDI – RREZIKU I POZICIONIT TË TITUJVE TË BORXHIT

3.1.1 Të përgjithshme

Formulari MKR SA TDI përmban informacion mbi pozicionet dhe kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) për titujt



e borxhit në librin e tregtueshëm, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat plotësojnë këtë formular në mënyrë të veçantë për monedhat kryesore (lekë, euro, USD), për të gjitha monedhat e tjera (përveç atyre kryesore) në të cilën kanë pozicione në këto instrumente në librin e tregtueshëm si dhe në total (për monedhat kryesore dhe për monedhat e tjera).

Bankat plotësojnë shenjën e monedhës në fushën “Monedha”.

Në rreshtat e tabelës konsiderohen metodat e mëposhtme për llogaritjen e kërkesës për kapital.

- Rreziku i përgjithshëm: metoda e bazuar në maturitet

- Rreziku i përgjithshëm: metoda e bazuar në kohëzgjatje

- Rreziku specifik

- Rreziku specifik për pozicionet në SIK

- Rreziqet jodelta (gamma dhe vega) të lidhura me opsionet

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmujor.

3.1.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban 9 kolona, me përmbajtje si më poshtë:

Kolona 010 dhe 020: Të gjitha pozicionet (në blerje dhe në shitje)

Në kolonat 010 dhe 020 bankat plotësojnë pozicionet bruto, pa marrë në konsideratë marrëveshjet e netimit dhe pa pozicionet e derivuara nga nënshkrimi i titujve të borxhit, nga të tretët sipas nenit 167 të rregullores.

Kolonat 030 dhe 040: Pozicionet neto (në blerje dhe në shitje)

Kolona 030 (pozicioni neto në blerje) dhe kolona 040 (pozicioni neto në shitje) i referohen pozicionit neto (në blerje apo në shitje), sipas nenit 146 të rregullores. Bankat llogarisin pozicionin neto si diferenca midis pozicionit në blerje/shitje dhe atyre në shitje/blerje në instrumentet financiare të të njëjtit lloj. Bankat plotësojnë vlerën e pozicionit neto, d.m.th. pozicionin e kompensuar për çdo segment maturiteti.

Kolona 050: Pozicione subjekte të kërkesës për kapital

Kjo kolonë u referohet pozicioneve të ponderuara, që janë subjekt i kërkesës për kapital, të llogaritura nën përjashtet e reflektuara në

rreshtat e këtij formulari. Për metodën e bazuar në maturitet këto pozicione janë të pasqyruara në nenin 155, shkronja “c”, ndërkohë që për metodën e kohëzgjatjes financiare këto pozicione janë të pasqyruara në nenin 156, shkronja “d” të rregullores.

Kolona 060: Kërkesa për kapital

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për secilën nga përjashtet e reflektuara nën rreshtat e këtij formulari si edhe totalin e kërkesës për kapital. Totali i kërkesës për kapital, i cili pasqyrohet në rreshtin 010, “Titujt e borxhit në librin e tregtueshëm”, është shuma e kërkesës për kapital për rrezikun e përgjithshëm (të pasqyruar në rreshtin 020 të po kësaj kolone në rast se banka përdor metodën e bazuar në maturitet ose në rreshtin 210, në rast se banka përdor metodën e bazuar në kohëzgjatjen financiare) dhe të kërkesës për kapital për rrezikun specifik (të pasqyruar në rreshtin 250, ku vlera në këtë rresht është shumë e rreshtave 251, 325 dhe 326), si dhe duke shtuar shumat e raportuara në rreshtat 340 dhe 350.

3.1.3 Përmbajtja e rreshtave

Në rreshtat e këtij formulari bankat raportojnë pozicionet në titujt e borxhit dhe kërkesat përkatëse për kapital duke u bazuar në kategorinë e rrezikut, maturitetin dhe metodologjinë e përdorur.

Rreshtat 012–013

Këto rreshta plotësohen vetëm për dy kolonat e para të formularit dhe përmbajnë informacion mbi pozicionet fillestare bruto të krijuara nga derivativët mbi normat e interesit dhe mbi titujt e borxhit (sipas nenit 147 të rregullores) dhe nga mjetet dhe detyrimet e tjera, vlera e të cilave varet nga ecuria e normës së interesit.

Rreshtat 020–200: Rreziku i përgjithshëm: Metoda e bazuar në maturitet

Në këto rreshta bankat plotësojnë pozicionet në titujt të borxhit në përputhje me nenin 155, pika 1, shkronja “a” të rregullores. Kështu, bankat shpërndajnë pozicionet neto në secilën prej segmenteve të përshtatshme të maturitetit (shih tabelën 22 të rregullores), në bazë të maturitetit të mbetur në rastin e titujve të borxhit me norma fikse dhe në bazë të periudhës së mbetur, deri në vendosjen e normës së re të interesit, në rastin e titujve të borxhit me normë interesi të ndryshueshme, duke bërë dallimin midis titujve me kupon 3% dhe atyre me kupon më të lartë se 3%.



Rreshtat 210–240: Rreziku i përgjithshëm: Metoda e bazuar në kohëzgjatjen financiare

Në këto rreshta bankat plotësojnë pozicionet në tituj të borxhit në përputhje me nenin 156, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të rregullores, sipas kohëzgjatjes së çdo instrumenti.

Rreshti 250: Rreziku specifik

Në këtë rresht, në kolonën 060, bankat plotësojnë kërkesën për kapital për rrezikun specifik (shih shpjegimin për kolonën 060).

Në këtë rresht, në kolonat nga 010 deri në 040, bankat plotësojnë pozicionet në titujt e borxhit subjekt i kërkesës për kapital të rrezikut specifik, si shumë e rreshtave 260–321.

Rreshti 251: Kërkesa për kapital për instrumentet e borxhit jo të titullzuar

Në këtë rresht bankat plotësojnë kërkesën për kapital për rrezikun specifik për titujt e borxhit, si shumë e kërkesave për kapital të katër kategorive të titujve të borxhit, të përcaktuar në rreshtat nga 260–320, si dhe për derivatet e kredisë (*n-th to default*) të vlerësuar (*rated*), të përcaktuar në rreshtin 321.

Në llogaritjen e kërkesës për kapital bankat konsiderojnë edhe reduktimet në kapital që rrjedhin si rezultat i mbrojtjes së pozicioneve me atë të derivativëve të kredisë, sipas nenit 151 të rregullores.

Rreshti 325: Kërkesa për kapital për pozicionet e titullzuara

Ky rresht i referohet nenit 153, pika 6 të rregullores. Në këtë rresht banka plotëson ekspozimet e titullzuara në kolonat 010–040 dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Rreshti 340: Përfaqje e veçantë për pozicionet në SIK

Ky rresht i referohet rrezikut të pozicionit për investimet në SIK, të cilat llogariten sipas nenit 161 të rregullores. Në këtë rresht bankat regjistrojnë pozicionet në SIK, sipas kolonave individuale 010–040 dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Kërkesa për kapital për pozicionet në SIK llogaritet si 32% e pozicionit neto në investimet në SIK. Në qoftë se një bankë llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit për investimet në SIK, kërkesa për kapital do të jetë më e ulët midis vlerës 32% të pozicionit neto dhe diferencës midis 40% të pozicionit neto dhe kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit të llogaritur për këto pozicione.

Rreshtat 350–380: Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta

Rreshti 350: Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 360–380.

Rreshti 360: “Metoda e thjeshtë” përfaqëson kërkesën për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të titujve të borxhit të specifikuar në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 370: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun gamma” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, pika 3 të rregullores.

Rreshti 380: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun vega” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, pika 5 të rregullores.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rreshti 010.

3.2 FORMULARI MKR SA EQU-RREZIKU I POZICIONIT TË TITUJVE TË KAPITALIT

3.2.1 Të përgjithshme

Ky formular përmban informacion mbi rrezikun e pozicionit dhe kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) të lidhur me titujt e kapitalit në librin e tregtueshëm, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmuor.

3.2.2 Përbërja e kolonave

Ky formular përmban 7 kolona, si më poshtë:

Kolonat 010 dhe 020: Pozicionet individuale (në blerje dhe në shitje)

Në kolonat 010 dhe 020, bankat plotësojnë pozicionet bruto, pa marrë në konsideratë marrëveshjet e netimit dhe pa pozicionet e derivuara nga nënshkrimi i instrumenteve financiare.

Kolonat 030–040: Pozicionet neto (në blerje dhe në shitje)

Pozicioni neto është diferenca midis pozicionit në blerje/shitje dhe atyre në shitje/blerje në instrumentet financiare të të njëjtit lloj. Bankat plotësojnë vlerën e pozicionit neto, pra pozicionin e kompensuar për çdo segment maturiteti. Gjatë plotësimit të këtyre kolonave, bankat marrin në konsideratë edhe kërkesat e nenit 167, i cili përcakton faktorët e reduktimit, aty ku këto janë të aplikueshëm.

Kolona 050: Pozicioni neto subjekt i kërkesës për kapital

Kjo kolonë i referohet pozicioneve neto që janë subjekt i kërkesës për kapital që llogaritet nën



përjasjet e reflektuara në rreshtat 010–120 të këtij formulari. Pozicioni total neto llogaritet si shumë e pozicioneve nga rreshtat 010–120 të këtij formulari në rreshtin “Tituj të kapitalit në librin e tregtueshëm”.

Kërkesa për kapital në %

Kjo kolonë përmban peshat me të cilat shumëzohen pozicionet neto subjekt të kërkesës për kapital, për të përlllogaritur kërkesën përkatëse për kapital.

Kolona 060: Kërkesa për kapital

Kolona 060 përmban kërkesën për kapital të llogaritur si prodhim i peshave në kolonën “Kërkesa për kapital në %” dhe pozicioneve neto subjekt i kërkesave për kapital nga kolona 050. Kërkesa totale për kapital është shuma e kërkesave për kapital nga rreshtat 1–6 të këtij formulari dhe pasqyrohet në rreshtat “Tituj të kapitalit në librin e tregtueshëm”.

3.2.3 Përbërja e rreshtave

Ky formular përmban rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

Rreshti 020: Rreziku i përgjithshëm

Rreshti “Rreziku i përgjithshëm” përmban pozicionet në tituj të kapitalit të përlllogaritura në përputhje me nenet 159 dhe 160 të rregullores. Në rreshtat individuale 021 dhe 022 bankat plotësojnë pozicionet e treguara në kolonat 010-070. Në rreshtin 020 plotësohen shumat përkatëse të rreshtave 021 dhe 022.

Rreshti 030: Kontrata të së ardhmes që bazohen në indeksat e aksioneve të tregtueshme në bursë, gjerësisht të diversifikueshme, subjekte të një përjasjeje të veçantë

Bankat plotësojnë rreshtin 030 me pozicionet në tituj të kapitalit dhe kontrata të së ardhmes të indeksit të kapitalit që tregtohen në bursa të njohura, dhe që përfaqësojnë indekse gjerësisht të diversifikuara aksionesh, të cilat janë subjekt i një qasjeje të veçantë, të përlllogaritura në përputhje me nenin 160 të rregullores.

Rreshti 040: Aksione të tjera përveç atyre të përaktuara në rreshtin 030

Bankat plotësojnë rreshtin 040 me pozicionet në tituj të tjerë të kapitalit, të ndryshëm nga kontratat e së ardhmes të indeksit të kapitalit që tregtohen në bursa të njohura dhe që përfaqësojnë indekse gjerësisht të diversifikuara aksionesh, të përlllogaritura në përputhje me nenin 159 të rregullores.

Rreshti 050: Rreziku specifik

Rreshti “Rreziku specifik” përmban pozicione në

tituj të kapitalit që janë subjekt i përlllogaritjes së rrezikut specifik në përputhje me nenet 158 dhe 160 të rregullores.

Rreshti 080: Përjasje e veçantë për pozicionet në SIK

Ky rresht i referohet rrezikut të pozicionit për investimet në SIK-të, sipas nenit 161 të rregullores. Në këtë rresht bankat regjistrojnë pozicionet në SIK sipas kolonave individuale 010–040 dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Kërkesa për kapital për pozicionet në SIK llogaritet si 32% e pozicionit neto në investimet në SIK. Në qoftë se një bankë llogarit kërkesë për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit për investimet në SIK, kërkesa për kapital do të jetë më e ulët midis vlerës 32% të pozicionit neto dhe diferencës midis 40% të pozicionit neto dhe kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit të llogaritur për këto pozicione.

Rreshtat 090-120: Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta.

Rreshti 090: Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jo-delta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 100–120.

Rreshti 100: “Metoda e thjeshtë” përfaqëson kërkesën për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të titujve të borxhit të specifikuara në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 110: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun gamma” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, pika 3 të rregullores.

Rreshti 120: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun vega” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, pika 5 të rregullores.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rreshti 010.

3.3 FORMULARI CR TB SETT – RREZIKU I SHLYERJES

3.3.1 Të përgjithshme

Formulari CR TB SETT përmban informacion mbi transaksionet në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm, të cilat janë akoma të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës) dhe kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes sipas nenit 163 të rregullores.

Bankat raportojnë në këtë formular informacione mbi rrezikun e shlyerjes të lidhur me



titujt e borxhit, titujt e kapitalit, monedhat dhe mallrat (*commodities*), të mbajtura në librin e tregtueshëm dhe në librin e bankës.

Në rast të transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës), bankat llogarisin diferencën në çmim, ndaj të cilës janë ekspozuar. Kjo është diferenca midis çmimit të shlyerjes të rënë dakord për instrumentin dhe çmimit aktual të tij, kur kjo diferencë përbën humbje për bankën.

Bankat shumëzojnë këtë diferencë me faktorin përkatës sipas tabelës 24 të rregullores. Për transaksionet, të cilëve u ka kaluar data e valutës jo më shumë se katër ditë, faktori i ponderimit është 0%.

3.3.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular është i përbërë nga kolona me përmbajtjen e mëposhtme:

Kolona 010: Transaksione të pashlyera me çmimin e shlyerjes

Në këtë kolonë do të paraqiten me çmimin e tyre të shlyerjes të gjithë transaksionet DVP të cilët rezultojnë të pashlyer pas datës së valutës, pavarësisht nëse ata rezultojnë me humbje ose me fitim pas datës së shlyerjes.

Kolona 020: Ekspozimi si rezultat i diferencës në çmim për transaksionet e pashlyera

Bazuar në nenin 163 të rregullores, bankat raportojnë në këtë kolonë diferencën midis çmimit të shlyerjes të rënë dakord për instrumentin dhe çmimit aktual të tij, kur kjo diferencë përbën humbje për bankën. Pra, bankat raportojnë në këtë kolonë vetëm transaksionet që rezultojnë me humbje pas datës së shlyerjes (datëvalutës).

Kolona 030: Kërkesa për kapital

Në këtë kolonë bankat raportojnë kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes për transaksionet DVP, sipas nenit 163 të rregullores.

Kolona 040: Ekspozimet e ponderuara me rrezik

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik, duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 040, rreshti 010.

3.3.3 Përmbajtja e rreshtave

Kjo tabelë përmban rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

Rreshti 010: Totali i transaksioneve të pashlyera në librin e bankës

Bankat raportojnë në rreshtin 010, informacion të agreguar, në lidhje me rrezikun e shlyerjes për transaksionet në librin e bankës.

Bankat raportojnë në qelizën 010/010

(rresht/kolonë), shumën e transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës) me çmimin e shlyerjes.

Bankat raportojnë në qelizën 010/020 (rresht/kolonë), shumën e diferencave në çmim, si rezultat i transaksioneve të pashlyera që rezultojnë me humbje.

Bankat raportojnë në qelizën 010/030 kërkesën agregate për kapital për transaksionet në librin e bankës.

Rreshtat 020-060: Transaksione të pashlyera

Në këto rreshta bankat raportojnë transaksionet në librin e bankës të cilat janë subjekt i rrezikut të shlyerjes sipas kategorive të përcaktuara në tabelën 24 të rregullores.

Për transaksionet, të cilëve u ka kaluar data e valutës jo më shumë se katër ditë, faktori i ponderimit është 0%.

Në rreshtat në vijim, bankat raportojnë të njëjtin informacion, si edhe në rreshtat 010–060, por të lidhur me transaksionet në librin e tregtueshëm.

3.4 FORMULARI MKR SA COM – RREZIKU I INVESTIMEVE NË MALLRA (COMMODITIES)

3.4.1 Të përgjithshme

Formulari MKR SA COM përmban informacion mbi pozicionet në mallra dhe kërkesën korresponduese për kapital për këto pozicione, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmuor.

3.4.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban kolonat me përmbajtjen si më poshtë:

Kolonat 010-020: Të gjitha pozicionet- në blerje dhe në shitje

Bankat plotësojnë pozicionet bruto në blerje/shitje duke konsideruar pozicionet në të njëjtin mall (*commodities*), sipas nenit 168, pikat 2 dhe 6 të rregullores.

Kolonat 030–040: Pozicionet neto

Bankat plotësojnë pozicionin neto, sipas nenit 168, pika 5 të rregullores.

Kolona 050: Pozicionet subjekt i kërkesës për kapital

Bankat plotësojnë pozicionet që janë subjekt i kërkesës për kapital sipas metodave të përcaktuara në nenin 168 të rregullores.

Kolona 060: Kërkesa për kapital

Bankat raportojnë kërkesën për kapital për rrezikun në mallra, sipas nenit 168 të rregullores.



Kolona 070: Ekspozimet e ponderuara me rrezik

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rreshti 010.

3.4.3 Përmbajtja e rreshtave

Ky formular përmban rreshtat me përmbajtjen, si më poshtë:

Rreshti 010: Pozicionet totale në mallra (commodities)

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra dhe kërkesën përkatëse për kapital.

Rreshtat - 020-060: Pozicionet sipas klasave të mallrave (commodities)

Për qëllime raportimi bankat grupojnë në katër klasat e mëposhtme mallrat në të cilët kanë investuar:

- Metale të çmuara (përveç arit);
- Metale bazë (zink, bakër etj.);
- Produkte bujqësore (*softs*);
- Të tjera.

Rreshti 070: Metoda e bazuar në segmentet e maturitetit

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra, subjekt i metodës së bazuar në segmentet e maturitetit, sipas nenit 172 të rregullores.

Rreshti 090: Metoda e thjeshtë

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra subjekt i metodës së bazuar në segmentet e maturitetit, sipas nenit 171 të rregullores.

Rreshtat 100–130: Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta.

Rreshti 100: Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 110–130.

Rreshti 110: “Metoda e thjeshtë” përfaqëson kërkesën për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione mbi mallra të specifikuar në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 120: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rreziqun gamma” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve mbi mallra, të llogaritur sipas nenit 180, pika 3 të rregullores.

Rreshti 130: “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rreziqun vega” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve mbi mallra, të llogaritur sipas nenit 180, pika 5 të rregullores.

3.5 FORMULARI MKR SA FX – RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

3.5.1 Të përgjithshme

Llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit u referohet dispozitave të rregullores “Për administrimin e rrezikut nga

pozicionet e hapura valutore” dhe neneve 173 dhe 174 të rregullores, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Kjo tabelë raportohet çdo gjashtëmuor.

3.5.2 Raportimi i pozicionit valutor neto

Kjo tabelë është e përbërë nga 13 kolona (010–100), nga të cilat tri kolona nuk janë të hapura për plotësim të dhënash (060-090).

Bankat plotësojnë fillimisht kolonat 020 dhe 030, për rreshtat 130 - “Euro” deri te rreshti “410” - monedha të tjera.

Pozicionet që bankat plotësojnë në këto qeliza janë të lidhura me ekuivalentin në lekë të pozicioneve të raportuara në formularin 32 të SRU-së, pa pozicionet në Ar. Kështu, bankat plotësojnë pozicionin në blerje dhe shitje (kolona 020 dhe 030 e formularit), për rreshtat 130 - euro deri rreshtin 400 - *Norwegian Corona* bazuar në formularin 32 të SRU-së si më poshtë:

- Pozicioni në blerje për çdo monedhë = shumë e pozicionit spot (në blerje) + pozicioni *forward* (në blerje) + pozicione në opsione në blerje.

- Pozicioni në shitje për çdo monedhë = shumë e pozicionit spot (në shitje) + pozicioni *forward* (në shitje) + pozicione në opsione në shitje.

Në qelizën 020/410 (kolonë/rresht) dhe 030/410 (kolonë/rresht) bankat raportojnë pozicionet e krijuara nga investimet në SIK, të cilat sipas nenit 174 trajtohen si monedhë e veçantë.

Shuma e rreshtave nga 130–410 në kolonën 020, që përfaqëson pozicione në blerje, plotësohet në qelizën 020/030 (kolonë/rresht) - Të gjitha monedhat e tjera (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Shuma e rreshtave nga 130–140 në kolonën 030, që përfaqëson pozicione në shitje, plotësohet në qelizën 030/030 (rresht/kolonë) - Të gjitha monedhat e tjera (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Bankat plotësojnë, gjithashtu, në qelizën 020/040 (kolonë/rresht) pozicionet në blerje dhe në shitje dhe në qelizën 030/040 duke iu referuar vlerës së raportuar në formularin 32 të SRU-së.

Bankat plotësojnë pozicionet neto për çdo monedhë (kolona 040 dhe 050), për rreshtat nga 130–140, si diferencë midis pozicionit në blerje dhe atij në shitje për çdo monedhë. Kjo diferencë i referohet kolonës 10 të formularit 32 të SRU-së.

Shuma e të gjitha pozicioneve neto në blerje për



rreshtat 130–410, plotësohet në qelizën 040/030 (kolonë/rresht) - Të gjitha monedhat e tjera (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Shuma e të gjithë pozicioneve neto në shitje për rreshtat 130–410, plotësohet në qelizën 050/030 (kolonë/rresht) - të gjitha monedhat e tjera (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Bankat plotësojnë në rreshtin 040, në kolonat 040 dhe 050 pozicionet neto (shitje ose blerje) në Ar.

3.5.3 Raportimi i kërkesës për kapital për pozicionin neto të hapur valutor

Bankat përllogarisin pozicionin valutor neto në blerje të bankës në të gjitha monedhat si shumë e rreshtave 030 dhe 040, në kolonën 040.

Bankat përllogarisin pozicionin valutor neto në shitje të bankës në të gjitha monedhat si shumë e rreshtave 030 dhe 040, në kolonën 050.

Vlera më e lartë midis pozicioneve të përcaktuar si më sipër përbën pozicionin valutor neto të bankës. Në rast se vlera e pozicionit valutor neto është më e lartë se 2%, bankat llogarisin kërkesën për kapital duke ponderuar këtë pozicion me 8%. Kërkesa për kapital plotësohet në kolonën 090, në rreshtat 030 dhe 040.

3.5.4 Rreziqe të tjera

Në llogaritjen e kërkesës totale për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit, bankat duhet të përfshijnë edhe kërkesën për kapital për rreziqet jodelta të lidhur me opsionet e këmbimeve valutore në librin e tregtueshëm.

Kjo kërkesë raportohet në rreshtat 050–080 të formularit, sipas kolonës 090.

Rreshti 050: Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 060–080.

Rreshti 060: “Metoda e thjeshtë” përfaqëson kërkesën për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të kursit të këmbimit të specifikuar në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 070: “Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun gamma” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të këmbimit valutor të llogaritur sipas nenit 180, pika 3 të rregullores.

Rreshti 080: “Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun vega” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të këmbimit valutor të llogaritur sipas nenit 180, pika 5 të rregullores.

3.5.5 Kërkesa për kapital

Bankat llogarisin kërkesën totale për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit në kolonën 090, rreshti 010 si shumë e kërkesave për kapital për pozicionet valutore (rreshti 030 + rreshti 040), si edhe kërkesës për kapital për opsionet-rreziqet jodelta (rreshti 050).

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik, duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 100, rreshti 010.

3.6 FORMULARI MKR SA SEC – METODA STANDARDE PËR RREZIKUN SPECIFIK TË TITULLZIMEVE

3.6.1 Të përgjithshme

Ky formular paraqet informacion mbi pozicionet (të gjitha/neto dhe në blerje/në shitje) dhe mbi kërkesat përkatëse për kapital, për elementin specifik të rrezikut në titullzimet/rititullzimet, të cilët mbahen në librin e tregtueshëm (që nuk janë të pranueshëm për portofolin e tregtueshëm të korreluar), sipas metodës standarde.

Ky formular paraqet kërkesën për kapital vetëm për rrezikun specifik të pozicioneve të titullzimit, në përputhje me nenin 152/1 të kësaj rregulloreje, të lidhur me nenin 153/1. Në rastet kur pozicionet e titullzimit të librit të tregtueshëm, janë të mbrojtur (*hedged*) nga derivativët e kredisë, zbatohen nenet 149 dhe 151 të kësaj rregulloreje. Kërkesa për kapital për rrezikun e përgjithshëm të këtyre pozicioneve, raportohet në formularin MKR SA TDI.

Pozicionet të cilat ponderohen me një peshë rreziku 1250% mundet, si alternativë, që të zbriten nga kapitali bazë i nivelit të parë (shih pikën “b” të nenit 99/1, pikën “b” të nenit 100/1 dhe nenin 108 të rregullores). Në këto raste, pozicionet e mësipërme raportohen në rreshtin 1.1.1.13 të aneksit 1 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.

3.6.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban 49 kolona, me përmbajtje si më poshtë:

Kolonat 0010-0020: Të gjitha pozicionet (në blerje dhe në shitje)

Këto pozicione janë të pasqyruara në nenin 138 dhe nenin 142, pika 1 të rregullores, së bashku me nenin 153/1 të rregullores (pozicionet e titullzimit).

Kolonat 0030–0040: Pozicionet që zbriten nga kapitali (në blerje dhe në shitje)



Sipas nenit 99, pika 1, shkronja “b”; nenit 100, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 108 të rregullores.

Kolonat 0050–0060: Pozicionet neto (në blerje dhe në shitje)

Sipas neneve 146, 147 dhe 152 të rregullores.

Kolonat 0061–0104: Ndarja e pozicioneve neto sipas peshave të rrezikut

Sipas neneve 114 (tabelat 13 dhe 14) dhe 109 të rregullores.

Ndarja kryhet veçmas për pozicionet në blerje dhe ato në shitje.

Kolonat 0403–0406: Ndarja e pozicioneve neto sipas metodave

Sipas nenit 109 të rregullores.

Kolona 0403: SEC - SA

Sipas nenit 113 të rregullores.

Kolona 0404: SEC - ERBA

Sipas nenit 114 të rregullores.

Kolona 0406: Të tjera (Peshë rreziku = 1250%)

Sipas nenit 109, pika 6 të rregullores.

Kolonat 0530–0540: Efekti i përgjithshëm (rregullim) kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në kreun V/nënkreu III të rregullores

Sipas nenit 119 të rregullores.

Kolona 0570: Përpara kufirit maksimal (Cap)

Sipas nenit 153/1 të rregullores, pa marrë në konsideratë mundësinë e zgjedhjes së paraqitur nga neni 152/1 i rregullores, i cili lejon bankën që të vendosë një kufi maksimal mbi kërkesën për kapital për rrezikun specifik të një pozicioni neto në një instrument borxhi, duke konsideruar humbjen më të madhe të mundshme të lidhur me rrezikun e dështimit.

Kolona 0601: Pas kufirit maksimal (cap)/kërkesat totale për kapital

Sipas nenit 153/1 të rregullores, duke marrë në konsideratë mundësinë e zgjedhjes së paraqitur nga neni 152/1 i rregullores.

3.6.3 Përmbajtja e rreshtave

Ky formular përmban 11 rreshta me përmbajtje, si më poshtë:

Rreshti 0010: Ekspozimi total

Ky rresht përmban shumën totale të tepricës së titullzimeve dhe rrititullzimeve (që mbahen në librin e tregtueshëm), të cilat raportohen nga banka që ka rolin/rolet e origjinuesit, investuesit apo sponsorit.

Rreshtat 0040, 0070 dhe 0100: Pozicionet e titullzimit

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 47 të rregullores.

Rreshtat 0020, 0050, 0080 dhe 0110: Pozicionet e rrititullzimit

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 45/4 të rregullores.

Rreshtat 0030–0050: Origjinuesi

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 48 të rregullores.

Rreshtat 0060–0080: Investuesi

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 55 të rregullores.

Banka, e cila mban një pozicion titullzimi në një transaksion titullzimi, për të cilin nuk është as origjinuesi, as sponsori dhe as huadhënësi fillestar.

Rreshtat 0090–0110: Sponsor

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 49 të rregullores.

Një sponsor, që titullzon, gjithashtu, aktivet e veta, do të plotësojë rreshtat e origjinuesit me informacion në lidhje me aktivet e veta të titullzuara.

3.7 FORMULARI MKR SA CTP – METODA STANDARDE PËR RREZIKUN SPECIFIK TË PORTOFOLIT TË TREGTUESHËM TË KORRELUAR

3.7.1 Të përgjithshme

Ky formular paraqet informacion mbi pozicionet e portofolit të tregtueshëm të korreluar (CTP) (i cili përfshin pozicione titullzimi, derivativë kredie *nth-to-default* dhe pozicione të tjera CTP, të përfshira në përputhje me nenin 153/2, pika 3 të rregullores) dhe që iu përgjigjen kërkesave për kapital sipas metodës standarde.

Formulari MKR SA CTP paraqet kërkesat për kapital vetëm për pozicionet e rrezikut specifik që caktohen për CTP, në përputhje me nenin 152/1 të rregullores, së bashku me pikat 2 dhe 3 të nenit 153/2 të rregullores. Në rast se pozicionet CTP të librit të tregtueshëm janë të mbrojtur (*hedged*) nga derivativët e kredisë, zbatohen nenet 97, 98 dhe 151 të rregullores. Ka vetëm një formular për të gjitha pozicionet CTP të librit të tregtueshëm, pavarësisht nga metoda që bankat përdorin për të përcaktuar peshën e rrezikut për secilin nga pozicionet, në përputhje me kreun V të rregullores. Kërkesat për kapital për rrezikun e përgjithshëm të këtyre pozicioneve raportohen në formularin MKR SA TDI – Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit.

Ky formular ndan pozicionet e titullzimit, derivativët e kredisë *nth-to-default* dhe pozicionet e tjera CTP. Pozicionet e titullzimit raportohen gjithmonë në rreshtat 0030, 0060 ose 0090 (në varësi të rolit që ka banka në titullzim). Derivativët e kredisë *nth-to-default* raportohen gjithmonë në rreshtin 0110. “Pozicione të tjera CTP” janë pozicione që nuk janë as pozicione titullzimi, as derivativë kredie *nth-to-default* (shih nenin 153/2, pika



3, të rregullores), por janë “të lidhur” në mënyrë eksplicite me njërin prej këtyre dy pozicioneve (për shkak të qëllimit të mbrojtjes (*hedging*)).

Pozicionet që ponderohen me një peshë rreziku 1250%, në mënyrë alternative, mund të zbriten nga kapitali bazë i nivelit të parë (CET1) (shih nenin 99, pika 1, shkronja “b”; nenin 100, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 108 të rregullores). Në këtë rast, këto pozicione raportohen në rreshtin “1.1.1.13” të aneksit 1 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.

3.7.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban 36 kolona, me përmbajtje si më poshtë:

Kolonat 0010–0020: Të gjitha pozicionet (në blerje dhe në shitje)

Sipas nenit 138 dhe nenit 142, pika 1 të rregullores, së bashku me pikat 2 dhe 3 të nenit 153/2 të rregullores (pozicione që i caktohen portofolit të tregtueshëm të korreluar).

Kolonat 0030–0040: Pozicionet që zbriten nga kapitali (në blerje dhe në shitje)

Sipas nenit 108 të rregullores.

Kolonat 0050–0060: Pozicionet neto (në blerje dhe në shitje)

Sipas neneve 146, 147 dhe 152 të rregullores.

Kolonat 0071–0097: Ndarja e pozicioneve neto sipas peshave të rrezikut

Sipas neneve 114 (tabelat 13 dhe 14) dhe 108 të rregullores.

Kolonat 0403–0406: Ndarja e pozicioneve neto sipas metodave

Sipas nenit 109 të rregullores.

Kolona 0403: SEC-SA

Sipas nenit 113 të rregullores.

Kolona 0404: SEC-ERBA

Sipas nenit 114 të rregullores.

Kolona 0406: Të tjera (peshë rreziku = 1250%)

Sipas nenit 109, pika 6 të rregullores.

Kolonat 0410–0420: Përpara kufirit maksimal (CAP) – Pozicionet neto të ponderuara në blerje/ në shitje

Sipas nenit 153/2 të rregullores, pa marrë në konsideratë mundësinë e zgjedhjes së paraqitur nga neni 152/1 i rregullores.

Kolonat 0430–0440: Pas kufirit maksimal (CAP) – Pozicionet neto të ponderuara në blerje/ në shitje

Sipas nenit 153/2 të rregullores, duke marrë në konsideratë mundësinë e zgjedhjes së paraqitur nga neni 152/1 i rregullores.

Kolona 0450: Kërkesa totale për kapital

Kërkesa për kapital përcaktohet si vlera më e madhe ndërmjet: *i*. peshës së rrezikut specifik që do të zbatohet vetëm mbi pozicionet neto në blerje (kolona 0430); dhe *ii*. peshës së rrezikut specifik që do të zbatohet vetëm mbi pozicionet neto në shitje (kolona 0440).

3.7.3 Përmbajtja e rreshtave

Ky formular përmban 12 rreshta me përmbajtje si më poshtë:

Rreshti 0010: Ekspozimi total

Ky rresht përmban shumën totale të tepricës së pozicioneve (që mbahen në portofolin e tregtueshëm të korreluar), të cilat raportohen nga banka që ka rolin e origjinuesit, investuesit apo sponsorit.

Rreshtat 0020–0040: Origjinuesi

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 48 të rregullores.

Rreshtat 0050–0070: Investuesi

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 55 të rregullores.

Banka, e cila mban një pozicion titullzimi në një transaksion titullzimi, për të cilin nuk është as origjinuesi, as sponsori dhe as huadhënësi fillestar.

Rreshtat 0080–0100: Sponsori

Sipas nenit 4, shkronja “c”, pika 49 të rregullores.

Një sponsor, që titullzon, gjithashtu, aktivet e veta, do të plotësojë rreshtat e origjinuesit me informacion në lidhje me aktivet e veta të titullzuara.

Rreshtat 0030, 0060 dhe 0090: Pozicionet e titullzimit

Portofoli i tregtueshëm i korreluar përfshin titullzimet, derivativët e kredisë *ntb-to-default* dhe mundësisht pozicione të tjera mbrojtëse (*hedging*), të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 153/2 të rregullores.

Derivativët e ekspozimeve të titullzimit, të cilët ofrojnë një pjesë proporcionale, sikurse pozicionet që mbrojnë (*hedging*) pozicionet CTP, përfshihen në rreshtin “Pozicione të tjera CTP”.

Rreshti 0110: Derivativët e kredisë ntb-to-default

Derivativët e kredisë *ntb-to-default*, të cilët mbrohen nga derivativë kredie *ntb-to-default*, në përputhje me nenin 149, pika 3 të rregullores, raportohen që të dy në këtë rresht.

Origjinuesi, investitori dhe sponsori i pozicioneve nuk janë të përshtatshëm për derivativët e kredisë *ntb-to-default*. Si pasojë, ndarja së cilës i nënshtrohen pozicionet e titullzimit, nuk mund të ofrohet për derivativët e kredisë *ntb-to-default*.



Rreshtat 0040, 0070, 0100 dhe 0120: Pozicione të tjera CTP

Në këtë rresht përfshihen pozicionet e mëposhtme:

- Derivatvët e ekspozimeve të titullzimit, të cilët ofrojnë një pjesë proporcionale, sikurse pozicionet që mbrojnë (*hedging*) pozicionet CTP;

- Pozicionet CTP, të cilat mbrohen nga derivativët e kredisë, në përputhje me nenin 151 të rregullores;

- Pozicione të tjera, të cilët përmbushin kërkesat e pikës 3 të nenit 153/2 të rregullores.

4. Kërkesa për kapital për rrezikun operacional

4.1 FORMULARI OPR - RREZIKU OPERACIONAL

4.1.1 Të përgjithshme

Ky formular shërben për raportimin e kërkesës për kapital për rrezikun operacional sipas metodës së thjeshtë, metodës standarde dhe metodës standarde të avancuar.

Bankat plotësojnë vetëm atë pjesë të formatit që u referohet llogaritjeve për përjasjen e zgjedhur për llogaritjen e kërkesës për kapital.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë të kuqe.

Ky formular raportohet çdo fundviti.

4.1.2 Metoda e thjeshtë

Për raportim e kërkesës për kapital sipas kësaj metode bankat raportojnë në kolonat 010–030 treguesin e të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për tri vitet e fundit të përllogaritur sipas nenit 184, pika 1, 2 dhe 3. (Vitet: T-3, T-2, T-1, ku T është viti aktual.)

Bankat raportojnë kërkesën për kapital në qelizën 070/010 (kolonë, rresht), të llogaritur bazuar në nenin 184, pika 4.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në qelizën 071/010.

4.1.3 Metoda standarde

Për raportimin e kërkesës për kapital sipas metodës standarde, bankat plotësojnë në rreshtat 030–100, në kolonat 010–030, treguesin e të ardhurave neto nga veprimtaria bankare për tri vitet e fundit, sipas nenit 185 (tabela 30) e rregullores.

Bankat raportojnë kërkesën për kapital në qelizën 070/020, të llogaritur bazuar në nenin 185, pika 1.

4.1.4 Metoda standarde e avancuar

Rreshtat 110 dhe 120, në kolonat 040–060 janë të lidhur me kërkesa specifike raportimi sipas

metodës standarde të avancuar. Bankat raportojnë në këto rreshta treguesin alternativ për dy linjat e biznesit, Bankingu Tregtar dhe Bankingu me Pakicë, sipas nenit 185, pika 2 dhe 3.

Bankat raportojnë kërkesën për kapital sipas kësaj metode në qelizën 070/020.

5. Formulari RMK-Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Ky formular shërben për të pasqyruar llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit nga ana e bankave.

Formulari raportohet çdo tremujor.

VENDIM

Nr. 244, datë 9.8.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN KORRIK 2023, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2000/1 prot., datë 7.8.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 5622 prot., datë 1.8.2023, protokolluar me tonën me nr. 2000 prot., datë 3.8.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për muajin korrik 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a., vihet re se, shoqëria vijon të përfshijë ndër të tjera në përllogaritjen e këtij çmimi, kostot e disbalancave. Bazuar në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin



e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e lëvrimit. Mbi këtë tarifë do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Në përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja përfshihen vetëm komponentët e përcaktuar në nenin 8 të metodologjisë.

- Mbështetur në nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2023, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë në mbeten në vlerën 1.06 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2023, përlogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin korrik 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	11.52
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.35
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh 15.33

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, do të jetë 15.33 lekë/kwh për muajin korrik 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin korrik 2023, prej 15.33 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim

Faqe | 15532

mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 245, datë 9.8.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “SELCA
ENERGJI” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“SELCA”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3; dhe 15, pika 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për



dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika, 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1974/1 prot., datë 4.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Selca Energji’ sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC ‘Selca’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Selca Energji” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010, të ndryshuar, është licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.7.2023, ka paraqitur aplikimin për modifikimin e kësaj licence për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selcës” nga 1.6 mw në 1.98 mw.

- Në pikën 2.3, të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, parashikohet se: “Çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë së kapacitetit të identifikuar në aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj licence. Rezulton se rritja e kapacitetit të instaluar nga 1.6 mw në 1.98 mw, kalon kufirin e identifikuar në aneksin A.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi, sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores dhe po ashtu rezulton se ka shlyer të gjitha detyrimet e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Selca Energji” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 15, pika 4, germat: “a”, “b” dhe “c”.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 15 “Modifikimi i licencës”,

Pika 4:

- germa “d”: ERE do të kërkojë qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara;

- germa “e”: duhet të depozitohet qëndrimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi rritjen e kapacitetit të instaluar;

- germa “f”: duhet të depozitohet qëndrimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në rast se leja për përdorimin e burimit ujor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” me kapacitet të shtuar prej 380 kw;

- germa “g”: shkresa e OSSH sh.a., në lidhje me miratimin e shtesës së kapacitetit duhet të depozitohet original ose fotokopje e njëzuar me origjinalin.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës, për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010, të ndryshuar, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selcës” nga 1.6 mw në 1.98 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Selca Energji” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 246, datë 9.8.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU
GREEN ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/15 prot., datë 4.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘EU Green Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271 prot., datë 18.4.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 19.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2023 dhe 21.6.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 231, datë 19.7.2023, vendosi të zgjasë afatin e vendimmarrjes përfundimtare deri në 30 ditë, për arsye të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin plotësues, të depozituar nga shoqëria me shkresën e datës 17.7.2023.

- Pas njoftimit nga ERE për vendimin nr. 231/2023, dhe dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar nga ky aplikim, shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1271/10 prot., datë 18.7.2023, nr. 1271/12 prot., datë 18.7.2023, nr. 1271/14 prot., datë 2.8.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores, në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EU Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “EU Green Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 247, datë 9.8.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “HYDRO SETA” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1890/7 prot., datë 4.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Hydro Seta’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 17.1.2019”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1890 prot., datë 7.7.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhe me vendimin nr. 234, datë 19.7.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës sipas kërkesës, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në median e shkruar (në datat 20.7.2023 dhe 21.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.7.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1890/3 prot., datë 27.7.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1890/5 prot., datë 1.8.2023 dhe nr. 1890/6 prot.,

datë 2.8.2023, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues për aplikimin.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 18.1.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 248, datë 9.8.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 58, DATË
31.3.2022, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË “HEC TËRFOJA” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“TËRFOJA”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 138/5 prot., datë 4.8.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 31.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘HEC Tërfoja’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Tërfoja’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 58, datë 31.3.2022, i ndryshuar me vendimin nr. 125, datë 4.4.2023, vendosi të licencojë shoqërinë “HEC Tërfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar brenda datës 18.4.2023.

- ERE iu drejtua Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU) dhe për dijeni shoqërisë “HEC Tërfoja” sh.p.k., me shkresën nr. 138/2 prot., datë 7.4.2023, duke e njoftuar për ndryshimin e vendimit të Bordit dhe detyrimin që i është lënë shoqërisë “HEC Tërfoja” sh.p.k. për të dorëzuar lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda datës 18.4.2023.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 138/3 prot., datë 13.4.2023, AMBU-ja ka konfirmuar se shoqëria “HEC Tërfoja” sh.p.k. ka riaplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të

burimit ujqor sipërfaqësor, por gjatë këtij aplikimi ka lindur nevoja për plotësimin e disa kushteve të evidentuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujqore. Gjithashtu, AMBU-ja ka ritheksuar se procedurat e trajtimit të një aplikimi të tillë mund të tejkalojnë dhe afatin prej 90 ditësh.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1128/1 prot., datë 27.7.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. serie 000194, nr. 219 prot., datë 17.7.2023, të miratuar me vendimin nr. 17, datë 12.7.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor Drin-Bunë për përdorimin të burimit ujqor për HEC “Tërfoja”, me një afat 5-vjeçar, deri më 12.7.2028.

- Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka realizuar rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE, lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Tërfoja” brenda datës 12.7.2028.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet, se: përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 58/2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria “HEC Tërfoja” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Tërfoja” brenda datës 12.7.2028.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HEC Tërfoja” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 250, datë 16.8.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
SUN ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAÏK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1892/7 prot., datë 11.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘ALB SUN Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892 prot., datë 7.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 19.7.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB SUN Energy” sh.p.k.,

në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkinë Fier.

- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në medien e shkruar (në datat 20.7.2023 dhe 21.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.7.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892/2 prot., datë 18.7.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. Në vijim të shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën nr. 1893/4 prot., datë 28.7.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 229/2023 dhe i evidentoi dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar nga ky aplikim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1893/5 prot., datë 28.7.2023, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB SUN Energy” sh.p.k.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1893/6, datë 3.8.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, grema “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri



në 30 vjet, por duke qenë se, nga sa deklaruar nga shoqëria, rezultoi se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ALB Sun Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ALB SUN Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 251, datë 16.8.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SHPK PËR LICENCIM, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e

energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/8 prot., datë 14.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Joint Venture 2B 1979 dhe 2T’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 3.8.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye se në këtë aplikim nuk ishte depozituar asnjë dokument, ku Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k., i cili mban dhe miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për ndërtimin e centralit fotovoltaike, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, t'i ketë njohur të drejtën shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për të operuar këtë central.

- ERE, me shkresën nr. 1964/6 prot., datë 8.8.2023, njoftoi shoqërinë për këtë vendim dhe i bëri me dije nevojën e plotësimit të dokumentacionit të konstatuar të munguar, si dhe se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen, dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.



- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964/7 prot., datë 10.8.2023, brenda afatit të sipërcituar, ka përcjellë në ERE deklaratën noteriale nr. 3723 rep., nr. 1949 kol., datë 10.8.2023, nëpërmjet së cilës përkatësisht shoqëria “2T” sh.p.k., shoqëria “2B 1979” sh.p.k dhe shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., deklarojnë se, sipas miratimit për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike, fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier”, nr. 7234/2, datë 22.11.2022, shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2 T” sh.p.k. do të kryejë operimin e impiantit gjatë të gjithë periudhës së afatit të licencës.

- Për sa më sipër dhe në referencë të përcaktimeve në faqet 1 dhe 2 të kontratës së nënshkruar me MIE-n (nr. 340 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023), ku është parashikuar e drejta për krijimin e një shoqërie për qëllime të veçanta, aplikuesi duhet të bëjë me dije në ERE, nëse ka njoftuar MIE-n mbi krijimin e kësaj shoqërie të re nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “d” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Të depozitohet në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për vetë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Germa “b”: Të depozitohet në ERE vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë “2T” sh.p.k. ku të miratohet financimi dhe vënia në dispozicion e vlerës financiare të nevojshme për ndërtimin e centralit fotovoltaike.

- Duke qenë se miratimi për pikën e lidhjes dhe VNM-së paraprake janë dhënë për kapacitetin 1950 kw, ndërkohë që në kontratën me MIE-n nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023, është parashikuar

që kapaciteti i centralit është 2 mw, aplikuesi duhet të depozitohet sqarimet përkatëse se përse në miratimin për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe VNM-së paraprake kapaciteti nuk është i njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën me MIE-n.

- Po ashtu, duke qenë se shoqëria ka parashikuar të ndërtojë veprën brenda vitit 2023, por dhe në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, vlerësohet t'i kërkohej informacion nëse ka filluar me punimet e saj.

- Në lidhje me sa deklaruar për jetëgjatësinë e pritshme të centralit prej 30 vjetësh, duke qenë se nga rastet analoge të mëparshme ka rezultuar se një central fotovoltaike e ka jetëgjatësinë 25 vjet, do t'i kërkohej aplikuesit të depozitohet në ERE dokumentacion teknik mbështetës për sa deklarohet nga ana e tij, për arsye se nga kjo jetëgjatësi do të varet dhe vlefshmëria e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë